



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË  
Seksioni i hetimeve dhe seancës paraprake

Nr. 1032 Akti

VENDIM

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

"PËR PUSHIMIN E ÇËSHTJES"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

**GJYQTAR: ERJON BANI**

Me pjesëmarrjen e sekretares gjyqësore **znj. Denada Toda**, në Tiranë, sot më datë 15.02.2019, pasi mori në shqyrtimin në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura, çështjen penale me Nr. 1032 Akti, me palë:

**KËRKUES:** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga Prokuror **Adriano Dyrmishi**.

**OBJEKTI:** Pushimin e procedimit penal me Nr. 7581 të vitit 2018, për veprën penale "*Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit zhvilluar në prani të **prokurorit Adriano Dyrmishi** pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes dhe çmoi dhe vlerësoi në tërësi provat e marra në seancë gjyqësore nënshtruar rregullave të gjykimit të seancës paraprake:

**Prokuroria:** Pranimin e kërkesës: Pushimin e procedimit penal me Nr. 7581 të vitit 2018, për veprën penale "*Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal.

VËREN

**I. Procedura.**

1. Se, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është paraqitur kërkesa me Nr. 1032 Akti, me objekt: Pushimin e procedimit penal me Nr. 7581 të vitit 2018, për veprën

penale “*Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal.

2. Gjykata në çështjen objekt gjykimi në zbatim të nenit 329/a dhe 329/b të të K.Pr.Penale brenda pesë ditëve vendosi të caktoj seancën gjyqësore paraprake, duke njoftuar prokurorin e çështjes **Adriano Dyrmishi**, për ditën dhe orën e gjykimit, që duhet të thirret gjatë seancës paraprake. Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se ishte prezent prokurori i çështjes. Ndodhur në këto kushte, Gjykata bazuar në nenin 329/b pika 2 nënë titullin “**Shqyrtimi i kërkesës**” parashikohet shprehimisht se: “1. Brenda pesë ditëve nga depozitimi i kërkesës, gjykata njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, për datën dhe orën e gjykimit. 2. Kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve. Kur pala nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, pa parashtruar shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj.”, vendosi të vijon procesin në prani të prokurorit.

3. Gjykata në çështjen objekt gjykimi vendosi të legjitimojë si palë vetëm prokurorinë, pasi nga prokurori më datë 28.09.2018 është marrë vetëm vendimi “*Për regjistrimin e procedimit penal*”, për veprën penale të “*Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga neni 245/1 të Kodit Penal, duke mos u regjistruar emrin i ndonjë personi si person ndaj të cilit zhvillohen hetime (nenet 293/1, 295/1, 296/1 e 2, 302, 303/2 – “b” e “d” dhe 308 i K.Pr.Penale)<sup>1</sup> të cilët janë subjekte që legjitimohen për të qënë pjesëmarrës në çështjet me objekt pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes. Këtu, Gjykata mban parasysh vendimin unifikues me Nr. 2, datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku ndër të tjera thuhet se: “32. Referuar çështjes së shtruar në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore nëse legjitimohen: “i kallëzuar”, “personi, të cilit i atribuohet vepra penale”, “personi ndaj të cilit, zhvillohen hetime”, për të bërë ankim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë me vend për të saktësuar se: e drejta e të pandehurit për të bërë ankim kundër vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes ose akuzës, në bazë të parimit të shtrirjes së të drejtave dhe garancive sipas nenit 34/4 të K.Pr.Penale, shtrihet edhe për personin nën hetim, qoftë ai në cilësinë e personit, të cilit i atribuohet vepra penale dhe në atë të personit, ndaj të cilit zhvillohen hetimet që është i kallëzuar, sepse, në fund të fundit, është i njëjti person, që në varësi të fazës së hetimeve paraprake, merr cilësi të ndryshme.

33. Referuar çështjes së shtruar në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore lidhur me pyetjen e dytë të shtruar për njësim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se: Në nenin 329 të K.Pr.Penale përcaktohen qartë si subjektet të legjitimuara

---

<sup>1</sup>Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr.3 të vitit 2002 kanë trajtuar qartë konceptin e subjektit procedural të “të pandehurit”. Terminologjia e përdorur nga Kodi i Procedurës Penale, gjatë fazave të ndryshme të procedimit penal, ndryshon nga çasti i fillimit të marrjes dijeni për veprën penale deri në përgatitjen dhe dërgimin e çështjes penale për gjykim. Cilësimi dhe emërtimi i subjekteve dhe i personave në raport me veprën penale fillojnë me termin: “personi, të cilit i atribuohet vepra penale” (neni 287 K.Pr.Penale), “person, ndaj të cilit zhvillohen hetime” (nenet 293/1, 295/1, 296/1 e 2, 302, 303/2 – “b” e “d” dhe 308, etj.) dhe më pas “i pandehur” që ndeshet në shumë dispozita të Kodit të Procedurës Penale. Autori i mundshëm i veprës penale mund t’i marrë këto emërtime në faza të ndryshme të procedimit penal. Këto emërtime nuk përfaqësojnë të njëjtën gjë dhe nuk kanë të njëjtin kuptim.

që bëjnë ankim kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, subjekti i “të dëmtuarit” dhe “i pandehuri”, çka do të thotë se këta subjekte marrin pjesë në këtë gjykim dhe kanë të drejtën e ankimit për këtë shkak, kur legjitimohen në gjykatën e apelit. Duke qenë se të drejtën e ankimit kundër vendimit të pushimit të çështjes penale e kanë, si i dëmtuari, ashtu edhe i pandehuri, ky i fundit edhe në cilësinë e personit nën hetim; detyrimisht për të garantuar një proces të rregullt ligjor sipas parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktorialitetit ku debati gjyqësor të zhvillohet natyrshëm; duhet të njoftohen me qëllim për t’u thirrur në gjykim jo vetëm prokurori që ka dhënë vendimin e pushimit të akuzës apo çështjes, por edhe i dëmtuari, si dhe i pandehuri apo personi nën hetim. Pra, të gjitha palët që në procesin penal tërheqin interesa të ligjshme.

**Në gjykimin me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes penale, sipas nenit 329 të K.Pr.Penale, ankimi kundër vendimit të pushimit të çështjes ose akuzës dhe e drejta për të marrë pjesë, duhet t’i njoftohen, në mënyrë që ai të thirret në gjykim, të dëmtuarit nga vepra penale, si edhe personit, ndaj të cilit zhvillohen hetime, pavarësisht nëse ai ka marrë apo jo, cilësinë e të pandehurit me aktin e njoftimit të akuzës. Mosnjoftimi për të marrë pjesë në gjykim, i këtyre subjekteve të sipërcituara sipas rregullave të K.Pr.Penale mbi njoftimet, përbën një proces të parregullt ligjor në kuptimin kushtetues dhe shkelje të rëndë procedurale sipas nenit 428, pika “ç” të K.Pr.Penale.”**

## **II. Rrethanat e faktit.**

3. Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi e provuar se, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është mësuar nga lajmet në disa media vizive dhe shkrimet e artikujve në disa gazeta dhe portale në vend, në lidhje me një bisedë mes gjyqtarit shqiptar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut Ledio Bianku dhe nënkryetarit të KQZ Denar Biba në vitin 2014.

4. Mediat vizive dhe të shkruara në vend, më datë 28.08.2018, kanë shkruar disa artikuj me përmbajtje “Biseda e Përgjuar/Blokimi çështjeve të pronave, si u shantazhua gjyqtari shqiptar në Strazburg”. Më poshtë në këtë artikull shkruhet “Një bisedë audio e përgjuar mes ish kryetarit të KQZ Denar Biba dhe Gjyqtarit Shqiptar në Gjykatën e Strazburgut, Ledio Bianku ka rikthyer në skenë historinë e katër viteve më parë. Atëherë qeveria shqiptare u përpoq të merrte një mirëkuptim nga Gjykata Evropiane për një stopim të proceseve gjyqësore në ngarkim të saj, nga individë të ndryshëm. Exit.al ka siguruar një regjistrim të pjesshëm audio, i cili sipas tyre u dërgua në mënyrë anonime, përmes postës elektronike të bisedës së zhvilluar mes Biankut dhe Bibes, e cila duket se është bërë në një mjedis publik me gjasa bar ose kafe dhe vazhdon artikulli, i cili është printuar i shkruar nga tre gazeta kryesore si Gazeta Panorama, Shqiptarja.com dhe faqja Ballkan ëeb.com. Në këto artikuj bëhet fjalë për një bisedë mes nënkryetarit të KQZ Denar Biba dhe Gjyqtarit shqiptar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strazburg Ledio Bianku për ndërhyrjet dhe shantazhet që i janë kërkuar këtij gjyqtari në vitin 2014, për pezullimin e çështjeve që kanë lidhje me pronat në Shqipëri. Këto fakte provohen me procesverbalin “Për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave” mbajtur më datë 29.08.2018.

5. Ndodhur në këto kushte, në kuadrin e veprimeve të para hetimore, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë i është drejtuar portalit **exit.al** me shkresën Nr. 12484 Prot., datë 29.08.2018, ku citohet shprehimisht se: *“Në kuadër të verifikimit të kallzimit penal m.11061 te vitit 2018, kërkohet të dërgohen të dhënat në vijim: 1- Konfirmim nëse në adresën elektronike të subjektit tuaj është dërguar ose jo material regjistrimi audio i një bisede të zhvilluar mes dy personave, të cilët në portalin tuaj, prezantohen me emrat Denar Biba dhe Ledi Bianku. Nëse një material i tillë ka mbërritur, kërkohet informacion mbi mënyrën e marrjes së tij, konkretisht koha e saktë, adresa e dërguesit, adresa IP nga është nisur ky regjistrim dhe cdo e dhënë tjetër e vlefshme për identifikimin e personit që ka përcjellë bisedën e ruajtur, pranë portalit Exit.al. 2- Gjithashtu kërkohet të dërgohet edhe materiali i regjistrimit të bisedës së përshkruar në pikën 1 të kësaj shkrese. Për shkak të afateve verifikuese të kallzimit penal, kërkohet që përgjigja të dërgohet menjëherë. Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.”*

6. Në përgjigje të shkresës së prokurorisë portali exit.al, me shkresën e datës 21.08.2018, me subjekt: *“Informacion në lidhje me shkrimin “Qeveria shantazhoi gjyqtarin shqiptar në Strazburg për bllokimin e çështjeve të pronave”, botuar në exit.al datë 28 Gusht 2018”,* citon shprehimisht se: *“Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, të datës 19 gusht 2018, dëshiroj t'ju informoj sa më poshtë. Informacioni në lidhje me takimin, tashmë pohuar publikisht mes zotërinjve Biba dhe Bianku, na u dërgua në mënyrë anonime nëpërmjet postës elektronike nga një adresë gmail, me emër llogarie të panjohur për mua. Adresa IP nga ku është dërguar mesazhi elektronik është: 209.85.220.65. Teksti i mesazhit të dërguar është bashkangjitur. Me email të veçantë, nga e njejta adresë gmail, u dërgua një regjistrim i pjesshëm audio në disa pjesë të shkëputura, nga një bisedë e pretenduar mes zotërinjve Biba dhe Bianku. Një kopje të këtij regjistrimi, të përpunuar nga ne për të rritur cilësinë e dëgjimit, po ju a dërgojmë në një disk USB, së bashku me këtë përgjigje. Mbas marrjes së informacionit me email, ne verifikuam nga burimet publike të gjitha të dhënat që përmbahen në të, përfshi datat e udhëtimeve të delegacionit shqiptar, përbërjen e delegacionit, datën e takimit të delegacionit në Strasburg, si dhe personat pjesëmarrës në takime. Verifikimet tona treguan që informacioni i dërguar ishte i vërtetë në përshkrimin e rrethanave që lidheshin me takimin e pretenduar Biba-Bianku. Ne gjithashtu verifikuam nëse takimi dhe biseda e pretenduar midis zotërinjve Denar Biba dhe Ledi Bianku kishte ndodhur në të vërtetë, duke kontaktuar Zotin Bianku, i cili konfirmoi se takimi kishte ndodhur me të vërtetë. Zoti Bianku gjithashtu konfirmoi, se qëllimi dhe përmbajtja e bisedës ishte ai i pretenduar në informacionin që na ishte dërguar, dhe, me aq sa i kujtohej, përmbajtja e pjesëve të regjistruara të bisedës ishte përgjithësisht e vërtetë. Mbas këtyre konfirmimeve ne vendosëm ta botonim shkrimin që ju i jeni referuar në kërkesën tuaj. Pas botimit të artikullit nga exit, Zoti Denar Biba në një sërë intervistash publike ka konfirmuar të gjitha informacionet e përfshira në artikullin tonë, si dhe ka konfirmuar se ai i ka thënë të gjitha fjalët e përmbajtura në regjistrimin audio, por ka deklaruar se ato janë nxjerrë jashtë kontekstit të bisedës. Ky pretendim i tij nuk mund të gjykohet nga ana jonë pasi regjistrimi që na është dërguar përmban vetëm disa pjesë të shkëputura dhe jo bisedën e plotë. Mbetemi në dispozicionin tuaj për çdo informacion të mëtejshëm që mund të keni nevojë.”*

7.1. Bashkëlidhur kësaj shkresë gjendet dhe teksti i mesazhit email me këtë përmbajtje: "Z. Sejmini. Artikulli i mëposhtëm është shkruar mbi bazën e informacioneve të sigurta dhe bazohet edhe në një bisedë, audiot e të cilës do ju nisen në vijim. Duke mos pasur mundësi të kontaktojmë Z. Bianku për konfirmim, me të cilin na thuhet se ju keni njohje direkte, po jua dërgojmë juve këtë material, duke pas parasysh edhe pavarësinë dhe profesionalitetin e Exit.al. Portali ku ne punojmë nuk pranoi ta publikojë për arsye që mund ti mendoni vetë. Mafia qeveritare presion Gjykatës së Strasburgut. Në seancën plenare të Kuvendit në 12 maj 2016, Kryeministri Rama deklaroi, me siguri të habitshme edhe për ata që e njohin, se 'kemi arritur marrëveshje me Gjykatën e Strasburgut dhe nuk do ketë më vendime pronash kundër Shqipërisë dhe se çështja e pronës u zgjidh', deklaratë e riprodhuar gjerësisht nga media me 12 dhe 13 maj 2016. Kjo deklaratë që në atë kohe na u duk shprehje injorance e Kryeministrit dhe një mashtrim publik i hapur dhe tipik i tij, duket se rezultoi e vërtetë. Që nga ajo datë Gjykata e Strasburgut nuk ka dhënë më vendime për çështje pronash kundër Shqipërisë, pavarësisht se sipas ekspertëve, në vendimin Manushaqe Puto Gjykata kishte deklaruar se do vazhdonte të trajtonte çështjet që ishin çuar në atë Gjykatë përpara vitit 2013.

Përveç provave dhe dëshmime të tjera, në mënyrë të veçantë biseda e mëposhtme na ndihmon të kuptojmë arsyet se pse Kryeministri Rama, çuditërisht, me 12 maj 2016, paska pasur të drejtë. Biseda e më poshtë është zhvilluar diku në Strasburg në 16 qershor 2014 mes Denar Bibes, Zv. i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe gjyqtarit shqiptar në Strasburg, Ledi Bianku, të cilit Biba i drejtohet me këto fjalë:

"Më mori Engjell Agaci, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave e më thotë ç' e ke Ledi Biankun?"

*I thashë....*

*Më thonë që nga gjithë këta që kemi afër ne ti e ke*

*Tha ...hajde të pijmë një kafe....ky muhabet të mërkurë të enjte...*

*Tha, kemi këto problemet, e di ti gjithë kjo historia që do kërkohet shtyrja*

*Të lutem tha, ti lutesh të na gjendet në gjithë këtë historinë...sot është Niko Peleshi ka takim"...*

*Biba vazhdon:*

*"Ma paguan ata biletën...."*

*Pastaj Biba i drejtohet Biankut:*

*"A të ndalon me ky tren në staion? Të ngelesh pa punë dhe ç'të vajti sakrifica!!!*

*Njeriu bën kompromise në jetë"*

*Këto janë pjesë nga mesazhi, i konfirmuar me audio, që një eksponet i preferuar i Partisë Socialiste në pushtet dhe aktualisht Zv.Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave por padyshim në emër të Qeverisë shqiptare i jep gjyqtarit shqiptar në Gjykatën e Strasburgut, Ledi Bianku. **Jepi përpjekur prej disa javësh të kontaktojmë zotin Bianku për konfirmim por pa sukses.***

Sidoqoftë, *pavarësisht se burimi i përgjimit ngelet anonim, analizat tona teknike na çojnë në konkluzionin se biseda është autoteknike dhe takimi në fjalë është konfirmuar edhe nga burime që i përmendim më poshtë. Fatkeqësisht biseda nuk del e plotë, është e shkëputur edhe niveli audio është i dobët...*”. Më pas nga prokuroria është bërë kqyrja e nurmit IPA 209.85.220.65 nga ku është dërguar mesazhi elektronik në portalin EXIT.AL nga të dhënat e përfituara elektronikisht nga programi Ehois, është mësuar se IP në fjalë del e kompanisë Google pa ndonjë të dhënë në interes të hetimit të mëtejshëm të identifikimit të adresës konkrete apo personit konkret. Këto fakte provohen me procesverbalin “Për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave” mbajtur më datë 11.01.2019.

8. Gjatë hetimeve paraprake është pyetur në cilësinë e personit që ka dijëni për veprën penale shtetasi **Denar Biba**, i cili ka deklaruar shprehimisht se: *“Diku nga periudha Maj ose Qershor 2014, më është kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, z.Engjëll Agaci, që të jem pjesë e grupit të punës që do të asistonte Zv/Kryeministrin Niko Peleshi në vizitën dhe takimin që ai do të bënte me autoritete të larta drejtuese të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg (GJEDNJ). Unë në atë kohë isha Kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), një agjenci qeveritare, në varësi të Këshillit të Ministrave, por në ndihmë të z.Peleshi u thirra në cilësinë time si ekspert i të drejtës kushtetuese. Me vendimin "Manushaqe Puto dhe të tjerë vs. Shqipërisë", GJEDNJ kishte dënuar shtetin shqiptar të dëmshpërblente ankuesit në një vlerë disa milion euro dhe e kishte konsideruar këtë një vendim "pilot". Sic shprehet GJEDNJ në këtë vendim në paragrafët 105 e 106 ( citoj nga vendimi): "Një prej faktorëve përkatës të shqyrtuar nga Gjykata në hartimin dhe zbatimin e procedurës së gjykimit-pilot ka qenë rreziku në rritje ndaj sistemit të Konventës që shkaktohet nga një numër i madh çështjesh të përsëritura që rrjedhin, ndër të tjera, nga i njëjti problem strukturor ose sistematik. Në fakt, detyra e Gjykatës, siç përcaktohet nga Neni 19, pra "të garantojë respektimin e angazhimeve të ndërmarra nga Palët e Larta Kontraktuese të Konventës dhe Protokollat e saj" nuk është arritur domozdoshmërisht më mirë duke përsëritur të njëjtat përfundime në një numër të madh çështjesh.*

*Ndërsa veprimi i Shtetit të paditur duhet të synojë kryesisht zgjidhjen e kësaj situatë jofunksionale dhe paraqitjen, sipas rastit, të mjeteve ligjore të brendshme efektive në lidhje me çështjet në fjalë, ai mund të përfshijë edhe zgjidhje të posaçme si zgjidhje miqësore me ankuesit ose oferta të njëanshme rregulluese në përputhje me kërkesa e Konventës. Gjykata mund të vendosë të shtyjë shqyrtimin e të gjitha çështjeve të ngjashme, duke i dhënë kështu Shtetit të paditur mundësi për t'i zgjidhur në këto mënyra të ndryshme. Megjithatë, nëse Shteti i paditur nuk arrin të marrë këto masa pas një gjykimi pilot dhe vazhdon të shkelë Konventën, Gjykata nuk do të ketë zgjidhje tjetër veç se të rifillojë shqyrtimin e të gjitha ankimeve të ngjashme të pazgjidhura të paraqitura pranë saj dhe t'i a nënshtrijë gjykimit, në mënyrë që të garantojë respektimin efektiv të Konventës (shihni Burdov (nr. 2)" Akoma më tej, në paragrafin 120, GJEDNJ vendos: "Gjykata do të shtyjë procedimet në lidhje me të gjitha kërkesat e reja të depozituara pranë saj pas dhënies së këtij vendimi në të cilin ankuesit ngrenë ankime të diskutueshme që lidhen vetëm me moszbatimet e zgjatura të vendimeve të formës së prerë për pronësinë për ekzekutimin e të cilave Shteti është përgjegjës, duke përfshirë kërkesat në të cilat janë ngritur edhe ankimet që pretendojnë mungesë të mjeteve ligjore efektive në lidhje me këtë moszbatim. Shtyrja*

do të jetë efektive për një periudhë prej 18 muajsh pasi vendimi aktual të marrë formë të prerë."

Kjo shtyrje ishte dhënë në 31.07.2012, me kërkesë të qeverisë Berisha dhe përfundonte në muajt e parë të vitit 2014. Me sa mësova, qeveria e re Rama, kalkulonte se, nëse gjykimet rifillonin, atëherë shteti shqiptar rrezikonte një penalitet në vlera disa dhjetra miliona Euro, gjë që do të rrezikonte falimentimin financiar të shtetit, me pasoja shumë të rënda për shtetasit shqiptarë. Pikërisht, me këtë shqetësim, z.Peleshi, në emër të qeverisë shqiptare, shkante në Strasburg për të kërkuar zyrtarisht shtyrjen me disa muaj të tjerë të procedurave të sipërpërmendura. Kur kemi mbërritur në Strasburg, i kam shkruajtur sms dhe i kam telefonuar mikun tim z.Ledi Bianku, i cili ishte me detyrë gjyqtar pranë GJEDNJ dhe i kam kërkuar të takohemi. Arsyeja e këtij takimi ishte sa njerëzore (cmallja me një mik të vjetër të cilin kisha disa muaj që nuk e kisha takuar që nga hera e fundit kur kisha qenë në Strasburg e ai më kishte ftuar në shtëpinë e tij për darkë), ashtu edhe për të diskutuar rreth qëllimit të vizitës së delegacionit zyrtar të qeverisë shqiptare. Ia bëra me dije edhe këtë të fundit gjatë bisedës sonë telefonike.

Z.Bianku nuk mundej të më takonte atë pasdite pasi ishte vonë, por lamë të pinim kafe në bar-restorantin e GJEDNJ të nesërmen në mëngjes. Të nesërmen jemi takuar siç e kishim lënë. U ulëm në një tavolinë në ambientet e jashtme të barrestorantit, në tavolinën që sugjeroi z.Bianku. Biseda ka qenë e gjatë, mbi 40 minuta, duke qenë se kishim kohë pa u parë dhe kishim c'të flisnim. Ka kaluar kohë e gjatë, por kujtoj që kemi folur për familjet tona, për miqtë e përbashkët. Folëm për qëllimin e vizitës dhe i kërkoja ndër të tjera të më jepte ide sesi mund të ishim sa më bindës në kërkesën tonë, duke qenë se ishte dhënë tashmë një shtyrje prej 18 muajsh. E pyeta nëse kishte pasur raste të tjera me shtete të tjera kur ishin vendosur "moratoriume" të ngjashme. Unë isha në dijeni të pamundësisë së tij formale për të ndikuar në këtë çështje, pasi tashmë bëhej fjalë për një vendim të marrë prej muajsh, por duke qenë se tashmë vendimimarrja ishte politike e jo juridike, i kërkoja që të na gjendej me se të mundej për të siguruar shtyrjen, duke qenë se në ato momente shteti shqiptar thjesht nuk i kishte mundësitë të paguante shuma aq të mëdha. Gjithçka në planin njerëzor, pasi isha i qartë që z.Bianku nuk kishte asgjë në dorë e madje, Kryetari i GJEDNJ edhe mund të mos i kërkonte fare mendim për kërkesën e qeverisë shqiptare. Nuk kujtoj me hollësi çdo fjalë, por kujtoj që z.Bianku nuk ndau të njëjtin qëndrim si unë dhe se më tha që ai s'mund të bënte më asgjë e që s'mund të jepej një shtyrje tjetër pas të parës. Gjithçka në tone fare normale, si një bisedë mes dy shokësh, që edhe kur kanë opinione të ndryshme për një çështje, e diskutojnë atë normalisht, pa më lenë të kuptoja për ndonjë "anomali" të bisedës sonë.

**Pas kësaj kaluam në tema të tjera, ndër to edhe se përse unë kisha pranuar të merrja detyrën e Kryetarit të KPP, kur në fakt dëshiroja Gjykatën Kushtetuese e në pamundësi Avokaturën e Shtetit. I sqarova se, me prorsit të Kryeministrit Rama, më thirri, Z.Agaci dhe më propozoi kreun e KPP. Fillimisht nuk pranova. Pasi dola nga takimi me atë, fola me disa miq të mitë të cilëve ua respektoj dhe kërkoj këshillën. Njëri prej tyre ndër të tjera më tha se: "Me tipa si Edi Rama, ky tren vetëm njëherë të qëndron në stacion" dhe se "Ke bërë sakrifica, do ngelesh pa punë" duke përmendur faktin që isha dorëhequr nga detyra e Zv/Kryetarit të KQZ disa muaj më parë dhe kisha mbi 6 muaj pa punë. Si rrjedhim pranova, ndonëse nuk më pëlqente si punë. Pasi folëm edhe për pak,**

*u ndamë duke u përqaftuar dhe me të fala për familjarët tanë. Z.Bianku në asnjë rrethanë nuk më la të kuptoja, e aq më pak e shprehu hapur, se biseda jonë nuk i kishte pëlqyer në ndonjë aspekt. Në vijim kam takuar z.Peleshi dhe i kam bërë me dije se, sipas z.Bianku, ne vështirë se mund të merrnim një shtyrje tjetër. Sikundër edhe ndodhi realisht. Në të vërtetë kjo shtyrje u siguroa dy vjet më pas, në vitin 2016, kur Minsistrat Arben Ahmetaj dhe Ylli Manjani shkuan sërish në Strasburg dhe takuan Kryetarin e Gjykatës, por edhe z.Bianku.*

*Katër vite më pas, një portal (Exit.al) publikoi një regjistrim audio, ku dëgjohem pothuajse vetëm unë, duke i folur dikujt që supozohet të jetë z.Ledi Bianku. Them supozohet, pasi ai pothuajse nuk flet. **Audio është krejtësisht e manipuluar, janë hequr copëza të tëra të bisedës, është hequr krejtësisht çdo gjë që ka thënë z.Bianku. Janë lënë vetëm disa fjali të miat, të shkëputura krejtësisht nga konteksti e të vendosura mekanikisht në një kontekst që nga portali në fjalë të mund të interpretohen si "shantazh" imi ndaj gjyqtarit Bianku, për diçka që nuk dihet e që nuk kuptohet përse ka ndodhur apo kohën kur ka ndodhur. Është një bisedë jashtë çdo lloj kordinate logjike apo kohore.** Kur jam pyetur nga gazetarët, unë e kam pranuar pa asnjë mëdyshje se po, ka pasur një bisedë mes meje dhe mikut tim Ledi Bianku 4 vite më parë në barrestorantin e GJEDNJ dhe riprodhova bisedën, për aq sa mundesha ta bëja këtë, tashmë që ka kaluar kaq shumë kohë. Sepse praktikisht është një e vërtetë e cila, jo vetëm nuk më shqetëson, por më bën të ndihem mirë për atë që kam bërë e do t' a bëj sa herë të jetë nevoja. Në bindjen time filozofike, ka raste kur interesat madhorë të shumicës dërmuese të individëve iu mbivendosen atyre të pak individëve, mjaft që kjo të jetë një periudhë e shkurtër e që pas kësaj interesat edhe të pakicave të respektohen.*

*Sikundër e kupton çdo njeri me një minimum arsyeje, unë në atë takim isha për qëllime të larta shtetërore, në interes absolut të publikut të gjerë shqiptar dhe dhe jo për qëllime që mund të identifikohet si "të parregullta". Praktikisht kërkesën që Zv/Kryeministri Peleshi ia parashtrroi Kryetarit të GJEDNJ, unë ia bëra z.Bianku që, nëse do të mundej, edhe ai të ndihmonte për tejkalimin e një situatë që vetëm sa do t'a përkeqësonte situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri, pasi rrezikohej që të mos paguheshin pagat e administratës publike dhe pensionet. Nëse do të disponohej audio regjistrimi origjinal, nga aparati origjinal që e ka bërë këtë regjistrim, do të kuptohej qartë se në bisedën tonë, nga ana ime nuk ka pasur asnjë ndikim të paligjshëm, se për shantazh as që mund të imagjinohet. **"Premtimet" e shpikura sikur unë po i ofroja ndonjë vend pune z.Bianku janë qesharake, sikur vetëm për faktin e thjeshtë që ai dhe familja e tij nuk do të kthehen më në Shqipëri, dhe këtë ai mua ma kishte thënë mëse njëherë. Sidoqoftë unë nuk mund t'ia lejoja kurrë vetës t'i imponohesha mikut tim, qoftë kjo edhe për dicka absolutisht të ligjshme e të moralshme sic ishte shtyrja me disa muaj të tjerë të një procedure që ishte shtyrë edhe herë tjetër, e askujt nuk i ishte dukur "e papërshtatshme" si qasje. Vlerësoj se e gjitha kjo, ishte një flluskë dhe fiasko e madhe e një pjese të politikës shqiptare, e përdorur për konjuktura banale të brendshme.**". Këto fakte provohen me procesverbalin "Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijani për veprën penale" mbajtur më datë 11.10.2018. Ndërkohë në kuadër në kuadër të pyetjes e z. Ledi Bianku, prokuroria ka konstatuar se ai ka hyrë për herë të fundit në territorin e Republikës së Shqipërisë më datë 09.08.2018 dhe ka dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë më datë 25.08.2018. Ndodhur në këto kushte, është pamundësuar pyetja e tij*



nga organi procedues. Këto fakte provohen me procesverbalin “Për kqyrjen dhe marrjen e dokumentit” mbajtur më datë 10.01.2019.

12. Mbështetur në të dhënat e mësipërme, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ka kërkuar pushimin e procedimit penal me Nr. 7581 të vitit 2018, për veprën penale “Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. Në kërkesën për pushim ndër të tjera thuhet se: “Nga hetimet e kryera ka rezultuar se nuk është përfituar ndonjë informacion me vlerë në lidhje me identitetin e personit që ka kryer përgjimin e lartpërmenduar për ty pyetur për rrethanat objekt hetimi si burim i kësaj prove. Kjo mangësi ngre debate mbi vlerën provuese të përgjimeve ambjentale të realizuara nga një person i pidentifikuar jashtë kuadrit të dispozitave procedurale mbi rregullat e përgjimit. Gjithashtu gjatë hetimit të çështjes penale nuk është bërë e mundur të perfitohet përgjimi i plote i shfaqur pjesërisht në medja. Në nenin 149 të K.Pr.Penale prashikohet se: "provat janë njoftime mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij". Në nenin 151/1 dhe 151/3 të K.Pr. Penale parashikohet: "Gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të K.Pr.Penale kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë, nëqë ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk çënon lirinë e vullnetit të personave". Në interpretim të këtyre dispozitave nuk kanë vlerën provuese të dhënat e pasqyruara në materialin e botuar fillimisht në portalin EXIT.AL dhe në pas medianë e peritshme, pasi kjo provë nuk është marrë në përputhje me parashikimet procedurale sepse nuk dihet personi (burimi) që ka realizuar këto përgjime.

Gjatë hetimeve nuk ka qenë e mundur të identifikohet personi që ka realizuar përgjimin, ku deklaratimet e tij, janë të domosdoshme, për arritjen në përfundime objektive dhe sqarimin e fakteve objektive, kontekstin e tyre dhe sa reale e afër të vërtetës është situata e paraqitur në medianë e shkruar dhe portalen on line. Gjithashtu nuk është bërë e mundur që të administrohet përgjimi i plotë dhe mjetet e përdorura për këtë përgjim çka do të na jepnin një tablo më të gjerë të gjithë kontekstit të bisedës së bërë midis shtetasve Denar Biba dhe Ledi Bianku. Në këtë kushte pavarësisht dyshimeve të ngritura, rezulton se, ato janë të pabazuara në prova. Në mungesë të deklaratimeve të personit që ka kryer përgjimin, i cili ka detyrimin që të japë çdo të dhënë në interes të hetimit, apo provave a indicieve të tjera, që duke u harmonizuar me njëra tjetrën, do të mund të kristalizojnë rrethanat objektive hetimi, rezulton se nuk provohet kryerja e veprës penale të "Ushtrimit i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuar nga neni 245/1 i K.Penal. Përsa më sipër, në bazë të nenit 328/dh të K.Pr.P, përderisa nuk provohet kryerja e veprës penale, procedimi penal nuk mund të vazhdojë. Neni 328 i K.Pr.Penal parashikon se kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë vazhdimin e procedimit prokurori jep vendim të arsyetuar për pushimin e procedimit.”.

### **III. Vlerësimi i Gjykatës.**

#### **1. Konisiderata të përgjithshme lidhur me gjykimin e seancës paraprake.**

13. Neni 148/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: “*Prokuroria ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit*”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rrjedh se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit. Një nga funksionet kryesore të shtetit të së drejtës është respektimi i kuadrit normativ nëpërmjet sigurimit të një drejtësie penale funksionale. Përcaktimi sa më i saktë i detyrave që ka secili aktor në procesin penal është një nga kërkesat kryesore që duhet të plotësojë kuadri kushtetues dhe ligjor në një shtet të së drejtës. Ndjekja penale që zhvillohet mbi bazën e akuzës publike duhet të jetë e mbështetur në dispozita ligjore të përcaktuara saktë, me qëllim dhënien nga gjykata të një vendimi të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm, duke garantuar mbrojtjen e individit nga arbitrariteti dhe shpërdorimi i pushtetit shtetëror. Ky detyrim i shtetit rrjedh nga fakti se ai është garanti i të drejtave dhe lirive themelore të individit dhe si i tillë duhet të parashikojë të gjithë mekanizmat e nevojshëm dhe procedurat konkrete për funksionimin e tyre, me qëllim dhënien e drejtësisë sipas kriterëve të përcaktuara qartë dhe në mënyrë sa më të detajuar<sup>2</sup>.

14. Për këtë qëllim, ligjvënësi ka parashikuar ngritjen e një organi të posaçëm për ushtrimin e ndjekjes penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Organi i prokurorisë është një nga mekanizmat e domosdoshëm që ndihmon në dhënien e drejtësisë penale. Ky organ i specializuar ka si funksion kryesor ushtrimin e ndjekjes penale në emër të shtetit dhe përfaqësimin e akuzës publike në gjyq. Ligji procedural penal parashikon të gjitha fazat e hetimit paraprak që duhet të kryhen nga prokuroria, me qëllim vënien para përgjegjësisë të personave që dyshohen si autorë të veprave penale. Me qëllim që prokurori të arrijë të ngrejë akuzë kundër këtyre subjekteve, ai duhet të mbledhë fakte dhe prova me anë të të cilave, në tërësinë e tyre, të mund të arrijë të provojë para gjykatës fajësinë e personit që akuzohet. Nisur nga parimi i ligjshmërisë, prokuroria është e detyruar të hetojë me hollësi dhe të mbledhë prova, nëse ka, kundër çdo të dyshuari.<sup>3</sup>Përballë këtij parimi qëndron ai i oportunitetit, sipas të cilit i takon vetë prokurorit të vendosë se cilat çështje duhet të hetojë dhe sipas cilës rradhitje ose prioriteti. Akuza është procedimi penal i një personi, ndaj të cilit bien dyshime si autor i kryerjes së një vepre penale, të parashikuar si të tillë nga legjislacioni penal<sup>4</sup>. Ngritja e akuzës publike nga prokurori konsiderohet si hapi i parë i ndjekjes penale të personit të dyshuar.

15. Sipas fjalorit të gjuhës së sotme shqipe, me ndjekje penale duhet të kuptohet veprimi juridik që ndërmerret kundër dikujt që ka shkelur ligjin<sup>5</sup>. Pra, ndjekja penale nënkupton kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji me qëllim vërtetimin e akuzës së ngritur nga prokurori. Procedimi i personit të akuzuar për kryerjen e një vepre penale nga organi i ngarkuar me këtë funksion përfshin hetimin e plotë nga organi i akuzës, mbi bazën e të cilit gjykata do të vendosë fajësinë ose pafajësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale<sup>6</sup>. Elementë të këtij procesi janë: caktimi i masave të sigurimit, njoftimi i akuzës dhe pyetja e të pandehurit, kqyrja dhe kontrolli i personit ose i

<sup>2</sup>Peter Badura, Staatsrecht (1996) fq. 597.

<sup>3</sup> Shiko Vendimin Nr. 3, datë 06.02.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>4</sup> Barron's Laë Dictionary, Fifth Edition, fq. 8.

<sup>5</sup> Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe (2002), fq. 838.

<sup>6</sup> Black's Laë Dictionary, Seventh Edition, fq. 1221.

banesës, sekuestrime, marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe mbledhja e provave të tjera<sup>7</sup>. Të gjitha këto hapa kryhen nën drejtimin dhe përgjegjësinë ekskluzive të prokurorit, i cili që në momentin që vihet në dijeni të veprës penale, kryen çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm për identifikimin e autorit të kësaj vepre dhe marrjen e tij në përgjegjësi penale.

16. Për të garantuar jo vetëm qenien aktive të organit të prokurorisë në ndjekjen penale dhe dënimin e personave të dyshuar si autorë të veprave penale, por edhe respektimin e të drejtave dhe lirive të individëve ndaj të cilëve ngrihet akuza ose janë dëmtuar si pasojë e veprës penale konkrete, ligjvënësi ka parashikuar në disa dispozita të K.Pr.Penale mundësinë që palët në proces për çdo veprim që ata mendojnë se cenojnë të drejtat dhe liritë e tyre t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës për kontroll.<sup>8</sup> Në këtë frymë, neni 278 i K.Pr.Penale parashikon se gjatë hetimeve paraprake për rastet e parashikuara nga ligji mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit dhe të viktimës vendos gjykata. Kjo dispozitë është miratuar nga ligjvënësi në vitin 2002, në kuadër të një koordinimi sa më të mirë të dispozitave që u japin palëve gjatë procesit të hetimeve paraprake disa të drejta procedurale. Më tej, në dispozitat e tjera të K.Pr.Penale, janë specifikuar disa nga rastet kur lejohet ankimi gjyqësor i vendimeve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake.

17. Gjithashtu, në nenin 291 dhe 329 të K.Pr.Penale, është parashikuar e drejta e kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin dhe pushimin e procedimit penal gjatë fazës së hetimeve paraprake. Ky kontroll ushtrohet në funksion të parimit të ligjshmërisë së procedimit penal dhe të garantimit të të drejtave të palëve të përfshira në të.<sup>9</sup> Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, kjo e drejtë për të kundërshtuar veprimet e prokurorit në rrugë gjyqësore, pra për t'iu drejtuar një autoriteti të pavarur dhe paanshëm, është në përputhje edhe me standartet e vendosura nga neni 42 i Kushtetutës. Në parim, ligjvënësi ia ka nënshtruar të gjitha veprimet hetimore paraprake kontrollit gjyqësor. **Praktika njeh dy mënyra për ushtrimin e këtij kontrolli: ose nëpërmjet gjykatës së themelit ose nëpërmjet gjyqtarit hetues, i cili, në legjislacionet e disa vendeve, është organi kompetent për të kontrolluar të gjitha veprimet hetimore paraprake para se çështja t'i kalojë për gjykim gjykatës kompetente. Në fund është gjykata që ka të drejtë të shprehet për të gjitha veprimet hetimore përfshirë edhe vendimin e pushimit të çështjes. Gjykata gjatë shqyrtimit të këtij vendimi duhet të konstatojë, nëse prokurori e ka pushuar çështjen në zbatim të ligjit dhe mbështetur në prova dhe argumente të mjaftueshme apo jo, ose nëse prokurori realisht i ka bërë të gjitha përpjekjet për të zbuluar faktin, pavarësisht përfundimit ku ka arritur.**<sup>10</sup>

18. Në kuadrin e reformës në drejtësi penale, lindi nevoja e harmonizimit të K.Pr.Penale me amendamentet Kushtetuese<sup>11</sup> dhe ligjet e tjera të miratuara nga Kuvendi i

<sup>7</sup> Kreu i VII i Kodit të Procedurës Penale të RSh.

<sup>8</sup> Shiko Vendimin Nr.14, datë 16.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>9</sup> Shiko Vendimet Nr. 7, datë 16.01.2013 dhe Nr. 196, datë 04.07.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

<sup>10</sup> Shiko Vendimin Nr. 5, datë 06.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>11</sup> Përpara ndryshime të bëra Kushtetutës me Ligjin Nr. 76 të vitit 2016, në nenin 148 të saj parashikohej shprehimisht se: "1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. 2. Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar. 3. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve." Pra, sipas kësaj dispozite kushtetuese prokuroria funksiononte në mënyrë të centralizuar. Ndërkohë me ndryshimet që i bënë nenit 148 me me Ligjin Nr. 76 të vitit 2016, parashikohet shprehimisht se: "1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në

Shqipërisë, në kuadër të Reformës në Drejtësi në fushën penale, si: Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si dhe ligjet e tjera që janë pjesë e paketës ligjore të reformës në drejtësi. Ndodhur në këto kushte, me Ligjin Nr. 35 të vitit 2017 u bënë ndryshimet në K.Pr.Penale, të cilat hynë në fuqi më datën 1 Gusht 2017. Në mënyrë të veçantë, janë reflektuar në K.Pr.Penale ndryshimet e reja kushtetuese dhe ligjore që lidhen me: a) Kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatës për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (neni 75/a) dhe rregullimin e marrëdhënieve mes Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm (neni 28 dhe 29 K.Pr.Penale); b) Pavarësinë hierarkike të prokurorit të çështjes (shfuqizuar paragrafët 4 dhe 5 të nenit 24 dhe neni 305 K.Pr.Penale. mbi marrjen përsipër të hetimeve); c) Parashikimi i figurës së gjyqtarit të seancës paraprake. Kështu, në relacionin dhe raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut që shoqëroi miratimin e Ligjit Nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhur me gjyqtarin e seancës paraprake thuhet shprehimisht: “...decentralizimi i institucionit të prokurorisë, u shoqërua me nevojën e parashikimit të figurës së gjyqtarit të seancës paraprake për garantimin e kontrollit të veprimtarisë së prokurorit gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe forcimin e gjykimit. Projektligji parashikon figurën e re të gjyqtarit të seancës paraprake, si gjyqtari që kontrollon veprimet dhe vendimmarrjen e prokurorit mbi fatin e çështjes. Përveç shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes, për dënimet me kundravajtje, gjyqtari i seancës paraprake ka për detyrë të kontrollojë nëse kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq është e bazuar në prova dhe ligj si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu edhe nga pikëpamja e përdorshmërisë së tyre dhe vlefshmërisë së akteve. Kjo figurë e re është vlerësuar e domosdoshme në kushtet e decentralizimit të institucionit të prokurorisë dhe, për pasojë, mungesën e një kontrolli hierarkik të punës së tij.....Qëllimi kryesor i parashikimit të kësaj figure për kontrollin e veprimeve të prokurorit gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe forcimi i fazës së hetimit, si faza më e dobët e procesit penal edhe përpara decentralizimit të prokurorisë, realizohet nëpërmjet kompetencave konkrete që i janë lënë këtij gjyqtari.”

19. Në K.Pr.Penale janë parashikuar në mënyrë shteruese kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, të cilat janë: 1) shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e akuzës ose të çështjes për kundërvajtjet penale mbi ankimin ankimin e të pandehurit, viktimës ose trashëgimtarëve e saj dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim<sup>12</sup>. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja

---

*emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. 2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit. 3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor. 4. Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimin të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se prokuroria tashmë nuk është më organ i centralizuar por një organ i decentralizuar dhe prokurorët janë të pavaruar në hetimin dhe ndjekjen penale.*

<sup>12</sup>Shiko nenin 328 të K.Pr.Penale.

e akteve. Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, por për njëherë ose disa nga akuzat ka vendosur pushimin, ankimi ndaj vendimit të pushimit shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq.<sup>13</sup> Në këtë rast ankimi shqyrtohet në prani të palëve, prokurorit, të pandehurit dhe me pjesmarrjen e domosdoshme të mbrojtësit të tij dhe me praninë e viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim, në një seancë me dyer të mbyllura.<sup>14</sup> Në përfundim gjyqtari i senacës paraprake vendos: **a)** lënien në fuqi të vendimit të pushimit, kur çmon se janë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi; **b)** kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, kur çmon se ato janë të paplota, duke përcaktuar drejtimit e thellimit të tyre dhe, kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen, si dhe cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë; **c)** kthimin e akteve prokurorit, duke e urdhëruar që të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes, kur çmon se hetimet janë të plota dhe rezulton se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjyq. Kur nga aktet rezultojnë të dhëna për vepra penale të tjera, që ndiqen kryesisht ose në ngarkim të personave të tjerë, gjykata mund të kërkojë që të kryhen hetime, edhe në rastet kur vendos sipas shkronjës “c”, të paragrafit 3, të nenit 329 të K.Pr.Penale. Në rastet e kthimit të akteve prokurorisë, gjyqtari i senacës paraprake i vendimin ja njofton edhe drejtuesit të prokurorisë; **2)** shqyrton kërkesën e prokurorit për pushimin e akuzës ose të çështjes penale kur procedohet për krime dhe kur është një nga rastet e parashikuara nga paragrafi i parë, i nenit 328 të K.Pr.Penale. Kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i senacës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve. Kur pala nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, pa parashtruar shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj. Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. Në këtë rast ankimi shqyrtohet në prani të palëve, prokurorit, të pandehurit dhe me pjesmarrjen e domosdoshme të mbrojtësit të tij dhe me praninë e viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, në një seancë me dyer të mbyllura.<sup>15</sup> Në përfundim gjyqtari i senacës paraprake vendos njëllë si rastet e cituara më lartë kur shqyrton ankimin kundër vendimit të prokurorit për pushimin e akuzës ose të çështjes për kundërvajtjet penale; **3)** shqyrtimin e kërkesës për revokimin e vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes me kërkesë të prokurorit, të viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar. Kërkesa shqyrtohet në dhomë këshillimi. Kur vendos pranimin e kërkesës, gjykata revokon vendimin e pushimit dhe i kthen aktet prokurorit, i cili rifillon hetimet;<sup>16</sup> **4)** shqyrtimin e ankimit të viktimës ose personit që ka bërë kallëzim për vendimit e prokurorit për pezullimin e hetimeve. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve. Kundër vendimit nuk lejohet ankim. Kur ankimi pranohet, gjykata vendos rifillimin e hetimeve.<sup>17</sup>

<sup>13</sup>Shiko nenin 329 pika 1 dhe 3 të K.Pr.Penale.

<sup>14</sup>Shiko nenin 332/b të K.Pr.Penale.

<sup>15</sup>Shiko nenin 332/b të K.Pr.Penale.

<sup>16</sup>Shiko nenin 329/c të K.Pr.Penale.

<sup>17</sup>Shiko nenin 326 të K.Pr.Penale.

## A. Lidhur me kërkesën për pushimin e çështjes.

20. Përgjegjësia penale është detyrimi ligjor i çdokujt, që shkel një rregullim normativ me karakter penal, për t'iu nënshtruar pasojave ligjore me karakter ndëshkues e parandalues. Nisur nga rëndësia që kanë organet proceduese penale përgjatë të gjithë veprimtarisë që përbën në tërësi procedimin penal, nga intensiteti i madh i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të nënshtruara dhe nga nevoja për zhvillimin e një procedimi të ndershëm, të rregullt dhe tërësisht në përputhje me ligjin, Kodi Penal ka parashikuar disa kushte kumulative që duhet të përmbushen në çdo procedim penal.

21. Kushtetuta e Republikës sonë në nenin 39 të saj shprehet ndër të tjera se: *“Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj”*, që njihet me parimin latin *“Nullum crimen, nulla poena sine legge”*, d.m.th. nuk ka krim, nuk ka ndëshkim pa ligj. Në bazë dhe në zbatim të këtij përcaktimi **rezervë ligjore**, Kodi Penal fillimisht në nenin 1 dhe më pas në nenin 2 të tij, respektivisht nën titujt **“Ligji penal dhe ndarja e veprave penale”** dhe **“Mosdënimi pa ligj”**, shprehet se: *“Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat në pjesën e posaçme të këtij Kodi”* dhe *“Askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë penale që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj.”* Sigurisht, Legjislatori nuk do të mjaftojë kurrsesi me kaq, kështu që, në pjesën e posaçme të Kodit Penal ka parashikuar edhe llojet e veprave penale dhe llojet apo masat përkatëse për to. Përcaktimi i saktë i normës që parashikon veprën penale, ka një rëndësi themelore, sepse është një parakusht për respektimin e parimit të ligjshmërisë, që një person të merret në përgjegjësi penale, e më pas ndaj tij të zbatohet sanksioni penal, sipas figurës së veprës penale saktësisht të kryer prej tij.<sup>18</sup>

22. Pra, sipas të drejtës sonë penale e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar të veprës penale, të parashikuar nga ligji penal. Respektimi dhe plotësimi i elementeve të figurës së veprës penale ka rëndësi të madhe, sepse ka të bëjë me zbatimin e parimit të ligjshmërisë. Për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Provuashmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë ligjorë, personi nuk mund të merret nën përgjegjësi penale dhe rrjedhimisht as të dënohet.<sup>19</sup> Prandaj, në çështjen konkrete, gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Figura e veprës penale, pasqyron formën juridike të veprës penale për rastin konkret. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi, nuk mund të

<sup>18</sup> Shiko vendimin Nr. 3, datë 02.11.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

<sup>19</sup> Shiko vendimin Nr. 204, datë 02.11.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

dënohet. Për rrjedhojë, gjyqtari i seancës paraprake në zbatim të nenit 329/b pika 3, të K.Pr.Penale duhet të vendosi pushimin e akuzës ose të çështjes kur janë rastet e paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi.

### **1. Lidhur me veprën penale të “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm”.**

23. Gjykata çmon se përpara se të konkludojë nëse kërkesa e prokurorisë për pushimin e çështjes penale është rezultat i një hetimi të plotë e të gjithëanshëm dhe i interpretimit të drejtë të ligjit material e procedural, fillimisht duhet të analizojë elementët e figurës së veprës penale të **“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”**, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. Në këtë dispozitë parashikohet shprehimisht se: *“Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premtton ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.”*

24. Në lidhje me objektin e veprës penale, **“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”**, gjykata thekson se qëllimi i mbrojtjes së marrëdhënies juridike nga norma penale e parashikuar në nenin 245/1 të Kodit Penal, është mbrojtja dhe ruajtja e ushtrimit të ligjshëm të funksioneve publike, si dhe ruajtja e besimit që individët kanë tek funksionarët që ushtrojnë detyra publike në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe besnikërisë së ushtrimit të detyrës publike, duke i shërbyer me përpikëri vetëm interesave publikë në mënyrë të paanshme dhe objektive. Në bazë të nenit 107/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nëpunësit publikë (dhe jo vetëm ata civilë) zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit. Prandaj, edhe ushtrimi i detyrës publike duhet të udhëhiqet vetëm nga respektimi i ligjit dhe shërbimi ndaj interesave publike, dhe jo i atyre interesave të tjera private të shkëmbimit që nuk duhet të mbivendosen apo të dalin mbi ndjekjen e interesave publike. Gjykata vëren se vepra penale e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, është parashikuar si rezultat i angazhimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në Konventën penale të Këshillit të Evropës për korrupsionin, ratifikuar me ligjin nr. 8778, datë 26.04.2001, ndryshuar me ligjin nr. 9369, datë 14.04.2005, si dhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit, ratifikuar me ligjin nr. 9492, datë 13.03.2006. Neni 18 i Konventës në fjalë synon, jo vetëm ndalimin dhe ndëshkimin e veprës penale të korrupsionit, por edhe të atyre veprave të tjera penale që e favorizojnë dhe e nxisin atë. Në nenin 12 të Konventës penale të Këshillit të Evropës për korrupsionin, është parashikuar angazhimi që, secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen

me qëllim premtimin, dhënien ose ofrimin, direkt ose indirekt, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon cilitdo që siguron ose konfirmon se është i aftë të ushtrojë ndikim në vendimmarrjen e cilitdo personi të referuar në nenet 2, 4, 5, 6, 9, 10, 11, në përputhje me këtë dispozitë, kur avantazhi që nuk i takon është për atë vetë, apo për të tjerë, sikurse dhe kërkimi, marrja ose pranimi i ofertës ose premtimi i një avantazhi të tillë, në përputhje me këtë ndikim, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose jo, ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar çon ose jo në rezultatin e synuar. Sipas relacionit shpjegues të Konventës, ky nen ka për qëllim mbrojtjen e transparencës dhe paanshmërisë së administratës publike. Neni 12 i Konventës, garanton luftën e gjithanshme ndaj dukurisë së korrupsionit në të gjitha format e shfaqjes së tij si kërcënim ndaj sundimit të ligjit dhe stabilitetit të institucioneve demokratike. Kriminalizimi i kësaj veprë penale synon të parandalojë rrethin e ngushtë të zyrtarëve apo të subjekteve politike, duke ndaluar ndikimin e paligjshëm të atyre që janë afër me zyrtarin dhe ushtrimin e pushtetit publik a privat dhe që përfitojnë favore të parregullta prej pushtetit.

**25. Në lidhje me anën objektive (*actus rea*) të figurës së veprës penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”.** Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Pra, ana objektive paraqet sulmin kriminal të shqyrtuar nga ana e tij e jashtme, nga pikëpamja e zhvillimit gradual dhe konsekuent të ngjarjeve dhe fenomeneve, të cilat fillojnë të vihen në lëvizje me kryerjen nga subjekti i veprimit ose mosveprimit dhe përfundojnë me ardhjen e një rezultati të caktuar kriminal. Nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore rezulton se, element të anës objektive të figurës së veprës penale janë: *i) veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm; ii) mënyra e kryerjes së veprës penale*, me të cilën kuptohet renditja e veprave, metodat e përdorura, karakteri kronologjik dhe specifika e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e vepërës penale. Mënyra e kryerjes së veprës penale lidhet ngushtësisht me mjetet e përdorura nga personi për realizimin e saj; dhe *iii) Koha, vendi dhe ambjenti i kryerjes së veprës penale*, me të cilën kuptohet grumbullimi dhe unitetit i kushteve konkrete, në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi kriminal, në të cilat zhvillohet lidhja shkakësore<sup>20</sup> dhe vjenë rezultati (pasoja) kriminale. Këto kushte ekzistojnë objektivisht dhe pavarësisht nga vullneti i subjektit i veprës penale.

25.1. Që të kemi konfigurimin e veprës penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm

<sup>20</sup> Shiko vendimin Nr. 06, datë 01.02.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku parashikohet shprehimisht se: “Bazuar në parimin latin “Nullum crimen, nulla poena sine causa” (Nuk ka krim, nuk ka dënim pa shkak), lidhja shkakësore, si një nga tre elementët e domosdoshëm të anës objektive të figurës së veprës penale e parashikuar në nenin 13 të K.Penal, vendos kushtin për ekzistencën e përgjegjësisë penale. Si e tillë ajo mund të përfytyrohet si një segment me dy skaje me pikë nistore shkakun, veprimin apo mosveprimin e kundërligjshëm dhe pikë fundore pasojën. Lidhja shkakësore shpreh pikërisht marrëdhënien që krijohet mes këtyre dy elementëve. E thënë ndryshe, lidhja shkakësore mund të kuptohet si marrëdhënia e varësisë që ekziston mes veprimit ose mosveprimit dhe pasojës përfundimtare të ardhur në një ngjarje konkrete, çka do të thotë se ekzistenca e pasojës shoqërisht të rrezikshme duhet të jetë rezultat i drejtpërdrejtë i veprimeve të të pandehurit dhe se po të mos ekzistonin veprimet konkrete të kryera prej këtij të fundit, nuk do të ekzistonte as pasoja. Ashtu si edhe çdo element tjetër i veprës penale, lidhja shkakësore duhet të provohet. Pra, në çdo gjykim duhet të evidentohet lidhja mes veprimit apo mosveprimit dhe pasojës së ardhur në çështjen konkrete objekt gjykimi, në mënyrë që vepra penale e parashikuar nga ligji të konsiderohet e kryer nga autori i veprimit apo mosveprimit.”.



ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, nga ana objektive kërkohet që subjekti aktiv të kryejë veprën penale nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme: 1) nga ana aktive, duke premtuar për t' i ofruar, ose propozuar ose dhënë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, **çfarëdo përfitimi të parregullt** personit, i cili premtun ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike. Ndërsa nga ana pasive: 2) kërkohet që subjekti aktiv të kryejë veprën penale nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme, duke kërkuar, marrë ose pranuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë nga personi që ka kërkuar këtë veprim. Dallimi midis nenit 245/1 të Kodit Penal dhe nenit 319/ç, qëndron në shkakun e përfitimit të parregullt, në rastin e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, përfitimi i parregullt jepet apo kërkohet për shkak të mundësisë së ndërmjetësimit të krijimit të një marrëdhënie të kundërligjshme midis korruptuesit dhe të korruptuarit, pra jo për shkak të ushtrimit apo mos ushtrimit të detyrës së nëpunësit publik. Në rastin e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal nuk parashikohet lidhja midis ushtrimit të detyrës midis funksionarit publik dhe ushtruesit të ndikimit të paligjshëm, pasi sjellja e subjektit aktiv që kryen ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndodh më përpara dhe jashtë kryerjes së marrëdhënies korruptive midis të ndërmjetësuarit dhe të korruptuarit (*pactum sceleris*).<sup>21</sup>

25.2. Gjykata e gjen me vend të theksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t' i krijojë gjykatës bindjen **“përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”** se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Sipas Vendimit Unifikues Nr. 7 të datës 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: *“Për vendimin përfundimtar lidhur me themelin e akuzës, gjykata disponon bazuar në bindjen e saj mbështetur në prova që vërtetojnë ose jo akuzën, pra jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Asnjë provë nuk mund të ketë një vlerë të paracaktuar, si në drejtim të fajësisë ashtu edhe të pafajësisë.”*. Pra, në procesin penal, organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo element që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri. Nga ana e tij, i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të provojë pafajësinë e tij, megjithatë, ai gëzon të drejtën të mbrohet në procesin penal, në përputhje me procesin e rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Lidhur me standardin e vlerësimit të provave GJEDNJ, në çështjen **Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë** shprehet se: *“Për të vlerësuar provat e faktit, Gjykata adopton standardin e të provuarit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, por shton se prova të tilla duhet të ndiqen nga bashkëekzistenca e deduktiveve përkuese, mjaftueshmërisht të fortë dhe të qartë ose nga prezumime të njëjta e të pakundërshtueshme të faktit.”*.

25.3. Gjithashtu, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *“1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.”*. Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjykata

<sup>21</sup> Shiko vendimin Nr. 239, datë 22.11.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kushtetuese në vendimin Nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: “*Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit*<sup>22</sup>dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuzat.”<sup>23</sup>Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit (“akuzës”, “veprës penale” për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt,) <sup>24</sup>ky duhet bërë në favor të të pandehurit. Në bazë të këtij parimi pranohet se **kur gjykata e shpall të pandehurin të pafajshëm, ajo nuk duhet të bindet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. I pandehuri shpallet i pafajshëm atëherë kur organi i akuzës nuk ka arritur të provojë në gjykatë se i pandehuri e ka konsumuar veprën penale në të gjithë elementët e saj përbërës ose kur ekziston një dyshim për akuzën, i cili sipas parimit të njohur *in dubio pro reo*, çmohet nga gjykata në favor të të pandehurit.**

25.4. Gjithashtu, përsa i përket standartit të provueshmërisë në procesin penal, Gjykata mban parasysh jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë. Kështë, në vendimin Nr. 196, datë 12.06.2013 Kolegji Penal i Gjykatës Lartë, ndër të tjera shprehet: “Kolegji Penal risjell në vëmendje edhe vendimin që i përket çështjes “Breukhoven kundër Republikës Çeke”, nr.44438/06, datë 21.07.2011 kur, GjEDNj përvijon jurisprudencë të qartë, në lidhje me mundësinë dhe vlerën e përdorimit të akteve, si dhe kualifikimit të akuzave nga ana e gjykatave të faktit. “Sipas jurisprudencës së krijuar nga gjykata, të gjitha provat duhet të merren në një seancë publike, në prani të të akuzuarit, me qëllim të mundësisë së kundërshtimit të tyre. Ka përjashtime nga ky parim, por ato nuk duhet të shkelin të drejtat e mbrojtjes, që sipas rregullit të përgjithshëm, të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 3 (d) të nenit 6, kërkojnë që të pandehurit t’i jepet një mundësi e përshtatshme dhe e duhur, për të paraqitur kundërshtimet e rastit dhe për t’i bërë pyetje dëshmitarit, si në fazën e deklarimeve ose në një fazë të mëvonshme. Në veçanti, të drejtat e mbrojtjes kufizohen, në një masë që është në kundërshtim me kërkesat e nenit 6, nëse dënimi është i bazuar vetëm, ose në një mënyrë vendimtare, në deklaratimet e një dëshmitari, për të cilat i akuzuari nuk ka pasur mundësi të vijë në dijeni dhe t’i kundërshtojë gjatë hetimit ose gjykimit (shiko dhe A.M. kundër Italisë, nr.37019/97, § 25, ECHR 1999-IX). (“Breukhoven kundër Republikës Çeke”, nr.44438/06, datë 21.07.2011, §43).”, ndërsa në vendimin Nr. 97, datë 20.03.2013 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë shprehet se: “Nga aktet dhe provat e shqyrtuara rezultoi se të dy gjykatat e faktit i kanë bazuar vendimet e tyre vetëm në një provë të vetme, siç janë bisedat telefonike, të cilat sipas vlerësimit të gjykatave të faktit,

<sup>22</sup>Në vendimin Nr. 5, datë 2 Shkurt 2001 të Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera thuhet se: “**Ndikimi i padiskutuëshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj.** Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale.”

<sup>23</sup>I njëjti qëndrim është mbajtur me vendimin Nr. 47, datë 07.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>24</sup>Shiko Vendimet Nr. 8, datë 08.05.2005 dhe Nr. 10, datë 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

janë zhvilluar ndërmjet të gjykuarve dhe pa i analizuar ato me asnjë provë tjetër, direkte ose indirekte, që provon fajësinë e të pandehurve, duke vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, duke i dhënë kësaj prove vlerë të paracaktuar.”. Nga përmbajtja e këtyre vendimeve rezulton se askush nuk mund të dënohet me një provë të vetme, e cila nuk lidhet me prova të tjera.<sup>25</sup>

25.5. Gjykata çmon se, është fakt i njohur që procesi i çmuarjes së provave është proces i ndërlikuar dhe kompleks, pasi përbërës të tij janë komponentë sa juridiko-faktikë, aq edhe të brendshëm, psikologjikë, nga të cilët duhet të udhëhiqet dhe nga i cili ndikohet trupi gjykues në formimin e bindjes së brendshme, pas shqyrtimit prej tij, në tërësi, të provave të administruara gjatë gjykimit, prova këto që doemos duhet të jenë marrë në zbatim të kërkesave të nenit 151 të K.Pr.Penale. Në nenin 152 të K.Pr.Penal nën titullin **“Çmuarja e provave”** parashikohet shprehimisht se: *“1. Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj.”*,<sup>26</sup>ndërsa në nenin 380 të K.Pr.Penale nën titullin **“Provat që mund të përdoren për të marrë vendimin”** parashikohet shprehimisht se: *“1. Për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor.”*. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se çdo provë vlerësohet në unitet me provat e tjera që do të thotë se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar, në të kundër nuk do të kishim çmuarje të provave. Pra, çmuarja e provave përbëhet prej veprimeve të Gjykatës për përcaktimin e vërtetësisë dhe mjaftueshmërisë së provave. **Vërtetësia e provave** është përcaktimi i saktësisë së fakteve provuese domethënë arritja në përfundimin nëse një provë i përgjigjet ose jo së vërtetës. **Mjaftueshmëria e provave** është përcaktimi që bëhet se bashkësia dhe tërësia e tyre lejon nxjerrjen e përfundimit të vërtetë për ekzistencën e faktit për të cilin ato (prova) janë mbledhur. Në qoftë se në bazë të provave të mbledhura është e pamundur arritja e një përfundimi të tillë, kjo gjë tregon se provat nuk janë të mjaftueshme. Në nenin 152 të K.Pr.Penale është

<sup>25</sup>Shiko vendimin Nr. 201, datë 05.07.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku thuhet shprehimisht: *“37. Një konkluzion i tillë i këtij Kolegji bazohet në nenin 152/1 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar dhe duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor.”* Kjo do të thotë se fajësia e të pandehurit në një proces penal nuk mund të konkludohet duke u bazuar vetëm në një provë të vetme, e pa mbështetur kjo me prova të tjera më tepër kur ajo nuk provon qartësisht fajësinë e të gjykuarve. Nëse do të konkludohej me një provë të vetme, atëherë kësaj prove do t'i jepej vlerë e paracaktuar, gjë që është në kundërshtim me kërkesat e nenit 152/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe në këtë rast nuk do të kishim çmuarje të provave, gjë që është kërkesë e detyrueshme kësaj dispozite.”.

<sup>26</sup>Shiko Vendimin Nr. 31, datë 31.01.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku thuhte se *“Kodi i Procedurës Penale në nenin 149 ka dhënë nocionin e provës duke përcaktuar se: “Provat janë njoftimet mbi faktet dhe rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë”. Ndërkohë që në nenin 152/2 të K.Pr.Penale është përcaktuar se “...2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicjet përveçse këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën”. Ndërkohë që ligjvënësi ka dhënë definicionin për sa i përket se çfarë është provë në kuptimin procedural kuptimin e indicjes si mjet procedural provueshmërie e jep teoria e së drejtës procedurale penale. Indicia është një pjesë e provës (probatio simplena) e cila nuk mund ta provojë në mënyrë të plotë një fakt por në mënyrë të përafërt. Gjykata vlerëson sedallimi midis provës dhe indicjes qëndron në atë që: nëse e para vërteton në mënyrë të drejtpërdrejtë ekzistencën ose jo të një fakti, e dyta është një rrethanë nga e cila mund të arrihet në një deduksion të logjikshëm, një konkluzion i përafërt mbi ekzistencën ose jo të një fakti.”.*

sanksionuar parimi i çmuarjes së lirë të provave. Provat shqyrohen sipas bindjes së brendshme duket zbatuar metodën dialektike gjatë vlerësimit të provave, sipas kësaj metode vërtetësinë e provave duhet ta shikojmë në lidhje të përgjithshme dhe varësi reciproke me provat e tjera dhe me faktet e çështjes, pra duhet ta shikojmë në mënyrë të gjithëanshme. **Me bindje të brendshme**, kuptojmë atë ndjenjë që formohet tek organi procedues në bazë të ndijimeve të përshtyojeve të tij për drejtësinë e përfundimeve të arritura për saktësisinë dhe mjaftueshmërinë e provave. Bindja e brendshme formohet nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre. Kjo kërkesë e ligjit ka për qëllim që të detyrojë Gjykatën që para se ajo të arrijë në përfundimin e saj, lidhur me vlerësimin e provave, të marrë në shqyrtim jo vetëm njëri anë të provës që bën fjalë për vërtetësinë e saj, por dhe anën e kundërt që e ve në dyshim ose e mohon këtë vërtetësi, **që gjykat të mbështetet jo vetëm te një provë, por në disa të tilla**, që duke i vlerësuar në tërësinë e tyre të lejojnë jo nxjerrjen e një përfundimi hipotetik por një të vetëm dhe të pakundërshtueshëm.<sup>27</sup>

25.6. Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata çmon të trajtojë paraprakisht nëse regjistrimi i bisedës i publikuar në portalin exit.al mund të përdoret si provë në procesin penal, dhe në çfarë kategorie provash futet, për të konkluduar më pas nëse veprimet e shtetasit Denar Biba përmbajnë elementët e figurës së veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal.

25.6.1. Në nenin 32 pika 2 të Kushtetutës parashikohet shprehimisht: “2. *Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.*”<sup>28</sup> Ky parim i rëndësishëm është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës së Strasburgut si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor dhe veçanërisht në drejtim të respektimit të së drejtës për t’u mbrojtur, e cila kërkon që i akuzuari të ketë mundësitë e duhura për të njohur dhe komentuar çdo provë që i paraqitet gjykatës. Në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjykata e ka për detyrë të vlerësojë në tërësi, nëse procedura lidhur me mënyrën se si u siguruan provat ishte e drejtë. Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimit të saj nga trupi gjyqësor nuk mund të mos nënkuptojë që procesi ishte i parregullt. Asnjë gjykatë nuk ka mundësi, që pa dëmtuar dhënien e “përmasës së duhur të drejtësisë”, të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, që janë edhe të kundërligjshme. Legjislacioni ynë procedural penal, doktrina si dhe jurisprudenca gjyqësore e kanë trajtuar gjerësisht mënyrën e marrjes së provave si një aspekt i rëndësishëm i procesit. Marrja e provave, sipas Kodit të Procedurës Penale, merr një kuptim të ri bazuar në sistemin akuzator, duke ndryshuar metodën e të proceduarit në lidhje me marrjen e provave në shqyrtimin gjyqësor, duke hequr dorë përfundimisht nga të gjitha ato norma të cilat sanksiononin pabarazinë e palëve në procesin penal në disfavor të individit dhe të së drejtave të tij. Provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor. Dispozitat e këtij kodi kanë ndryshuar

<sup>27</sup>Shiko “E Drejta Procedurale Civile I”, Ribotimi i katërt, Prishtinë 2004, autori Prof.Dr.Faik Brestovci, faqe 249-250.

<sup>28</sup> Në nenin 4 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet shprehimisht se: “3. *Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërdrejt, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe*”.

rrënjësisht mënyrën e procedimit penal në të gjitha fazat e tij. Prandaj, mosrespektimi i dispozitave ligjore të vendosura për aktet e procedimit shërben njëkohësisht dhe si shkak pavlefshmërie që ndikon drejtpërdrejt mbi ecurinë e procesit gjyqësor.<sup>29</sup>

25.6.2. Në nenin 151 të K.Pr.Penale nën titullin “**Marrja e provave**” parashikohet shprehimisht se: “**1. Gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. 2. Në gjykim provat merren me kërkesën e palëve. Gjykata vendos me urdhër, duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të panevojshme. Disponimet mbi marrjen e provave mund të revokohen në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor. 3. Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë në qoftë se ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit. Gjykata vendos për marrjen e provës pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj. 4. Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë procedimi.”.** Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton se është parashikuar sanksioni i papërdorshmërisë së provave, duke nënkuptuar se gjykatat nuk mund të bazojnë vendimin e tyre në prova të papërdorshme. Po kështu me qëllim mosdhënien e një vendimi mbi prova të papërdorshme, legjislatori ka parashikuar se nuk ka asnjë kufizim kohor në lidhje me ngritjen e një pretendimi të tillë, pavarësisht gjendjes apo shkallës ku ndodhet procedimi, qoftë edhe në Gjykatë të Lartë dhe në kuptim të parimit të disponimit, gjykata merr në shqyrtim edhe kryesisht papërdorshmërinë në proces, duke shtrirë papërdorshmërinë edhe për fazën e hetimeve paraprake apo edhe në procedurën e masave të sigurimit. Subjektet e procedimit penal, gjatë veprimtarisë së tyre të përditshme, hartojnë akte procedurale, marrin prova me të cilat evidentohet dhe vërtetohet veprimtaria e tyre, sipas rasteve dhe mënyrave të parashikuara nga ligji procedural penal. Kodi i Procedurës Penale i ka përcaktuar të gjitha etapat në të cilat do të kalojë procesi penal, duke bërë një rregullim të hollësishëm të këtij procesi. Një pjesë të rëndësishme gjatë procesit penal zënë aktet procedural dhe provat. Legjislatori e ka parashikuar qartë mënyrën sesi duhen përpiluar aktet dhe merren provat, por në praktikë vihen re raste ku subjektet e procedimit penal i shkelin këto kërkesa që parashikon kodi. Pasojat që vijnë nga këto veprime janë tepër të rënda për procesin, saqë mund të çojnë në prishjen e vetë procesit. Papërdorshmëria lidhet me mosrespektimin e një rregulli të caktuar në ligj, shkelja e të cilit sjell papërdorshmërinë e aktit ose të provës. **Gjykata vlerëson se, duke qenë se papërdorshmëria është një lloj pavlefshmërie që nuk godet aktin në vetvete, por vlerën e tij provuese, ajo (papërdorshmëria) është një sanksion procedural me karakter të veçantë pasi godet vetëm ato akte që kanë vlerë provuese.**<sup>30</sup>Pra, papërdorshmëria përbën një ves të aktit procedural penal që mishëron marrjen e provës, madje një nga veset më të rënda të tij. Nga ana tjetër, papërdorshmëria vepron edhe si *sanksion procedural* që godet provat e marra në kundërshtim me ndalimet e parashikuara nga ligji. Në këtë kuptim, papërdorshmëria nuk përbën një pavlefshmëri të natyrës së përgjithshme, por një sanksion procedural të mëvetësishëm që godet vetëm provat, pra, nuk godet aktin në aspektin formal, por vlerën e tij provuese, me një fjalë, aspektin e tij thelbësor. Për këtë arsye, ajo nuk përfshihet në

<sup>29</sup> Shiko Vendimin Nr. 7, datë 27.04.2005 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

<sup>30</sup> Shiko Vendimin Nr. 119, datë 01.07.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Titullin III (Seksioni V) të Kodit që normon institutin e pavlefshmërisë të akteve procedurale. Kjo natyrë e dyfishtë e papërdorshmërisë (*ves dhe sanksion*), nuk lejon që prova të përdoret, ndonëse vesi i aktit të marrjes mund të korrigojë. Mundësia që konstatimi dhe ngritja e papërdorshmërisë së provës të bëhet edhe kryesisht, si dhe pamundësia e korrigjimit të saj, i jep këtij vesi, si rregull, natyrë absolute.

26.3. Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se përgjimi i bisedës të publikuar në portalin exit.al, ku pasqyrohet një bisedë midis shtetasit Denar Biba dhe shtetasit Ledi Bianku me detyrë gjyqtar pranë GJEDNJ-së, është një përgjim i fshehtë i bërë nga persona anonim dhe nuk është siguruar pajisja ku është mbartur regjistrimi për të konkluduar mbi vërtetësinë e saj. Nga provat që gjenden në dosje nuk rezulton që kjo bisedë të jetë realizuar nga z.Ledi Bianku dhe nuk rezulton që ky përgjim të jetë i autorizuar nga gjykata apo prokuroria. Ndodhur në këto kushte, Gjykata çmon se ky regjistrim i fshehtë është i papërdorshëm, për këto arsye: **së pari**, përgjimi i fshehtë nga persona të tretë anonimë për organin procedues bëhet në shkelje të hapur të ligjit. Kështu, në nenin 121 të Kodit Penal nën titullin “**Ndërhyrje të padrejta në jetën private**” parashikohet shprehimisht se: “*Vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve ose të figurave, dëgjimi, regjistrimi ose transmetimi i fjalëve, fiksimi, regjistrimi ose transmetimi i figurave, si dhe ruajtja për publikim apo publikimi i këtyre të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit pa pëlqimin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.*”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se regjistrimi i bisedave private dhe transmetimi i tyre pa pëlqimin e personave që janë regjistruar përbën veprë penale. Prandaj, nga një veprim i paligjshëm që përbën në vetvete veprë penale nuk mund të përfitohen të dhëna të ligjshme.<sup>31</sup> **Së dyti**, nëse përgjimi i bisedës të publikuar nga portali exit.al është rezultat i përgjimeve parandaluese, Gjykata çmon se në kuptim të nenit 221 pika 5 nën titullin “**Kufijtë e lejimit**” ku parashikohet shprehimisht se: “*5. Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë.*”, rezultatet e këtij përgjimi nuk mund të përdoren në procesin penal. **Së treti**, duke qenë se përgjimi në rastin konkret nuk është autorizuar nga gjykata apo prokuroria, në kuptim të nenit 226 të K.Pr.Penale nën titullin “**Ndalimi i përdorimit**” ku parashikohet shprehimisht se: “*1. Rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren kur janë bërë jashtë rasteve të lejuara nga ligji ose kur nuk janë respektuar dispozitat e këtij seksioni.*”, rezultatet e këtij përgjimi nuk mund të përdoren në procesin penal.

26.4. Megjithatë, Gjykata çmon të trajtoj nëse regjistrimi i bisedës i publikuar në portalin exit.al mund të konsiderohet një provë “**Dokument**”. “*Dokumenti konceptohet si një provë jashtëprocedurale, e paraformuar, i krijuar materialisht jashtë procesit, i cili hyn dhe bëhet pjesë e këtij procesi nëpërmjet mekanizmit të “marrjes.”*<sup>32</sup> Në nenin 191 të K.Pr.Penale nën titullin “**Marrja e dokumenteve**” parashikohet shprehimisht se: “*1.*

<sup>31</sup> Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, nga ana e saj, është shprehur se *problemet me ndërhyrjet në jetën private mund të lindin sa herë që kryhen regjistrime në hapësira private ose publike, qoftë edhe duke përdorur metoda të kamufluara, por ruajtja dhe përdorimi i të dhënave përbën ndërhyrje në jetën private të individit* (Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Çështja “Rotaru” kundër Rumanisë, 04 maj 2000, [GC] kërkesa nr. 27798/95, § 65-, ECHR 2000-II.)

<sup>32</sup> “Il Codice di Procedura Penale spiegato con esempi pratici, dottrina, giurisprudenza, schemi, tabelle e appendice normative”, Quarto Edizione a cura di Luigi Tramontano, Casa Editrice La Tribuna, 2006

*Lejohet marrja e dokumenteve që përfaqësojnë fakte, persona ose sende nëpërmjet fotografimit, filmimit, fonografimit ose çdo mjeti tjetër.*” Nga përmbajtja e kësaj dispozite, rezulton se nocioni “dokument” përfshin **përveç dokumentit shkresor edhe çdo send apo instrument që është në gjendje të përfaqësojë fakte, persona apo sende që kanë lidhje me objektin e të provuarit dhe në të cilin ruhen gjurmë fotografike, filmike, fonografike, kompiuterike etj.** Pra, ligjvënësi parashikon si dokument jo vetëm shkresat që përmbajnë deklarin dhe përshkrimin e një fakti, por edhe çfarëdo objekt tjetër përfaqësues që ka një përmbajtje të rëndësishme e cila materializohet nëpërmjet formave të ndryshme që parashikon neni 191/1 i K.Pr.Penale. Në këtë kuptim, janë dokumente edhe fotografitë, shiritat filmike ku regjistrohen imazhet, shiriti apo suport magnetik si cd, kasetat dhe dokumente të tjera, nëse plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 191/1 të K.Pr.Penale. Fotografimi, filmimi, fonografia etj, janë mjete që shërbejnë për materializimin dhe konkretizimin e provës në dokument, nëpërmjet të cilit bëhet përfaqësimi i fakteve, personave dhe sendeve. Në lidhje me **fotografinë**<sup>33</sup> si dokument duhet sqaruar se janë të tilla ato që përfaqësojnë fakte, persona apo sende të caktuara të cilat rezultojnë të jenë krijuar jashtë procedimit, me autor të ndryshëm nga organi procedues. **Shiriti filmik**<sup>34</sup> përmban përfaqësimin e një fakti, personi apo sendi dhe konsiderohet në jurisprudencën e huaj si një provë dokumentare me rekuizita të veçanta. Shiriti filmik, në këtë mënyrë nuk është një shkresë private dhe për të nuk nevojitet nënshkrimi si për shkresat private por duhet të verifikohet autenticiteti i tij. **Në këtë rast duhet të verifikohet autorësia e regjistrimit dhe vërtetësia e asaj që është e dokumentuar në të.** Nëse arrihet në përfundimin se sekuencat e tij nuk janë të montuara apo të manipuluar atëherë ai duhet të përdoret për qëllime të provës. Në një vendim Gjykata e Kasacionit të Italisë ndër të tjera thekson: *“Duke qenë se neni 234, paragrafi i parë i kpp, duke sjellë risi në krahasim me kodin e abroguar, parashikon shprehimisht marrjen e dokumenteve që përfaqësojnë fakte, persona ose sende, përmes fotografimit, filmimit fonografimit apo çdo mjeti tjetër, filmi kinematografik që përmban paraqitjen e një fakti çmohet si provë dokumentare që ka rekuizita të veçanta: është dokument figurativ (nuk karakterizohet nga shkrimi, por nga imazhet), është i tipit dëshmues (përderisa përmban përshkrimin – dëshmi të një fakti), është i drejtpërdrejtë (sepse jep përshkrimin e atypëratyshëm të ngjarjeve)...”*<sup>35</sup>Neni 191/1 i K.Pr.Penale lejon që të merren si dokument edhe **regjistrimet fonografike** siç mund të jenë ato në një “cd” apo kasetë audiofilmike.<sup>36</sup> Regjistrimi i zërit apo tingujve mund të shoqërohet edhe me marrjen e pamjeve video. Gjithashtu, neni 191/1 i K.Pr.Penale bën fjalë edhe për dokumente të formuara me “çdo mjet tjetër”. Në fakt është jurisprudenca ajo që do të përcaktojë kuptimin e këtij termi rast pas rasti. Por, megjithatë mund të thuhet se në këtë term përfshihen edhe: **Dokumentet kompjuterike** të cilat përfaqësojnë fakte me vlerë

<sup>33</sup> “Fjalor i Shqipërisë së Sotme”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botimet TOENA, Tiranë 2002, fq.353, fjala fotografi: fytyra apo figura e dikujt apo e diçkaje, e riprodhuar në letër me anë aparatesh të posaçme

<sup>34</sup> “Fjalor i Shqipërisë së Sotme”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botimet TOENA, Tiranë 2002, fq. 332, termi filmim: nënkupton regjistrimin e pamjeve në një shirit ose fletë celuloidi që përdoret për të riprodhuar diçka në kinematografi etj.

<sup>35</sup> Seksioni V i Gjykatës së Kasacionit të Italisë, vendim nr. 10309, 15 nëntor 1993

<sup>36</sup> “Fjalor i Shqipërisë së Sotme”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botimet “TOENA”, Tiranë 2002, fq. 349, termi regjistrim fonografik nënkupton regjistrimin të zërit apo tingujve në një pllakë, film etj.

provuese nëpërmjet mjeteve elektronike, siç mund të jetë ditari elektronik, e-maili, dokumenti i nxjerrë nga Sistemi i Administrimit Total të Informacionit (TIMS), etj. Në kushtet e zhvillimeve teknologjike, gjithnjë e më tepër kompiuteri po përbën një mjet të rëndësishëm për pasqyrimin dhe ruajtjen e të dhënave të ndryshme, nga ana e autoriteteve shtetërore apo individëve privatë. Pra, mund të flitet për një dokument në formë elektronike.

26.4.1. Gjykata çmon se ligji nuk ka parashikuar shprehimisht se cilat janë kushtet që duhet të plotësojë dokumenti për t'u marrë si mjet prove në një proces penal. Megjithatë nga analiza e dispozitave përkatëse të K.Pr.Penale rezulton se marrja e tij, përveç rregullave të përgjithshme të parashikuara për të gjitha llojet e provave (nenet 149-151 K.Pr.Penale), duhet t'i nënshtrohet edhe kufizimeve specifike të mëposhtme: ***Së pari, dokumenti të rezultojë i formuar materialisht jashtë procesit ose procedimit penal, por jo domosdoshmërisht para procedimit.*** Ky kusht lidhet me konceptin e dokumentit si një provë "e paraformuar" dhe ndryshimin që ekziston ndërmjet koncepteve "akt procedural" dhe "dokument".<sup>37</sup> Siç u sqarua dhe më sipër, nëse do të kemi një dokument të krijuar brenda procedimit, kemi të bëjmë me një akt procedural dhe jo me një dokument. Për t'u pranuar si mjet prove në proces, dokumenti duhet të jetë krijuar para procedimit ose gjatë tij. Kjo nënkupton që dokumenti krijohet në mënyrë të pavarur nga procedimi dhe jo për qëllime të tij. Në përgjithësi, marrja e tij si provë ndodh kur dokumenti është krijuar para procedimit. Si përjashtim, mund të merret edhe një dokument i formuar gjatë zhvillimit të procedimit, por jashtë tij. Kjo justifikohet me faktin se ai mund të përfaqësojë ngjarje natyrale që përfshihen në tërësinë e fakteve objekt të shqyrtimit gjyqësor. Pra e rëndësishme është që dokumenti të jetë krijuar jashtë procesit që zhvillohet dhe të hyjë në të si provë nëpërmjet marrjes. ***Së dyti, objekti i dokumentit jashtëprocedural të përmbajë fakte objekt të procesit.***<sup>38</sup> Përmbajtja e dokumentit duhet të jetë e rëndësishme, pra të përfaqësojë "fakte, persona, ose sende" që kanë lidhje me çështjen objekt të gjykimit. Nuk mund të merren me cilësinë e provës, dokumentet që përmbajnë të dhëna të panevojshme për procesin. ***Së treti, "të ketë qartësi dhe prejardhje të sigurt."***<sup>39</sup> Pra, kërkohet që dokumentit t'i njihet autori dhe të dhënat që ai përmban të mos jenë të paqarta. Në nenin 194 të K.Pr.Penale nën titullin "**Dokumentet anonime**" parashikohet shprehimisht se: "***1. Dokumentet që përbëjnë njoftime anonime nuk mund të merren dhe as të përdoren, përveçse kur përbëjnë provë materiale ose janë bërë nga i pandehuri.***" Kuptohet dhe nga termi i përdorur se i tillë është ai dokument për të cilin nuk ka të dhëna për autorin, pra nuk dihet se kush e ka bërë dokumentin, për arsye se autori i tij është i panjohur. "***Në këtë sens "anonim" është një dokument që nuk i atribuohet askujt.***"<sup>40</sup> Dokumenti anonim nuk përmban shënime për autorin.

26.4.2. Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata çmon se regjistrimi i fshehtë i një bisede midis shtetasit Denar Biba dhe shtetasit Ledi Bianku me detyrë në kohën e

<sup>37</sup> "Il Codice di Procedura Penale Spiegato son esempi pratici, dottrina, giurisprudenza, schemi, tabelle e appendice normative", Quarto Edizione a cura di Luigi Tramontano, Casa Editrice "La Tribuna", 2006, fq. 461

<sup>38</sup> Në nenin 150 të Kodit Penal nën titullin "**Objekti i provave**" parashikohet shprehimisht se: "***1. Janë objekt prove faktet që kanë lidhje me akuzën, fajësinë e të pandehurit, caktimin e masave të sigurimit, dënimin dhe përgjegjësinë civile, si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale.***"

<sup>39</sup> H. Islami, I.Panda, A. Hoxha "Procedura Penale, Komentar", Tiranë 2003, fq. 248

<sup>40</sup> F. Cordero "Procedura Penale", Terza Edizione, Giuffrè, 1995, fq. 686



regjistrimit gjyqtar pranë GJEDNJ-së, të bërë nga persona anonimë dhe e përcjellë nëpërmjet një adrese të panonjur në portalin exit.al, hynë në kategorinë e provës “dokument”, pasi në vetvete pasqyrojnë fakte nëpërmjet “fonografimit”, pra regjistrimit të zërit. Prandaj, Gjykata çmon të analizojë nëse plotësohen të gjitha kushtet që ky dokument të merret si provë në rastin konkret. **Së pari**, në rastin konkret regjistrimi i fshehtë i një bisede midis shtetasit Denar Biba dhe shtetasit Ledi Bianku me detyrë në kohën e regjistrimit gjyqtar pranë GJEDNJ-së është bërë jashtë procedimit penal. **Së dyti**, regjistrimi fshehtë ka lidhje me procesin. **Së treti**, regjistrimi i fshehtë hynë në kategorinë e provës “dokument”, pasi në vetvete pasqyrojnë fakte nëpërmjet “fonografimit”, pra regjistrimit të zërit. Në rastin konkret provohet se burimi i regjistrimit të fshehtë të zërit në bisedën midis shtetasve Denar Biba dhe Ledi Bianku *ngelet anonim, biseda nuk del e plotë, është e shkëputur edhe niveli audio është i dobët*. Gjithashtu, gjatë pyetjes së tij shtetasi Denar Bida ndër të tjera ka deklaruar se: **“Audio është krejtësisht e manipuluar, janë hequr copëza të tëra të bisedës, është hequr krejtësisht çdo gjë që ka thënë z.Bianku. Janë lënë vetëm disa fjali të miat, të shkëputura krejtësisht nga konteksti e të vendosura mekanikisht në një kontekst që nga portali në fjalë të mund të interpretohen si "shantazh" imi ndaj gjyqtarit Bianku, për diçka që nuk dihet e që nuk kuptohet përse ka ndodhur apo kohën kur ka ndodhur. Është një bisedë jashtë çdo lloj kordinate logjike apo kohore.”** Ndodhur në këto kushte, kur nuk mund të konfirmohet vërtetësia e regjistrimit të fshehtë dhe jemi përpara një dokumenti anonim, atëherë në kuptim të nenit 194 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: **“I. Dokumentet që përbëjnë njoftime anonime nuk mund të merren dhe as të përdoren...”**, regjistrimi i fshehtë nuk mund të përdoret në këtë proces penal në cilësinë e provës “dokument”.

26.5. Gjykata çmon se në rastin konkret në kuadrin e provave që mund të përdoren në këtë proces është deklarimi i shtetasit Denar Biba, i cili ndër të tjera ka deklaruar se: **“Pas kësaj kaluam në tema të tjera, ndër to edhe se përse unë kisha pranuar të merrja detyrën e Kryetarit të KPP, kur në fakt dëshiroja Gjykatën Kushtetuese e në pamundësi Avokaturën e Shtetit. I sqarova se, me prorsi të Kryeministrit Rama, më thirri, Z.Agaci dhe më propozoi kreun e KPP. Fillimisht nuk pranova. Pasi dola nga takimi me atë, folam me disa miq të mitë të cilëve ua respektoj dhe kërkoj këshillën. Njëri prej tyre ndër të tjera më tha se: "Me tipa si Edi Rama, ky tren vetëm njëherë të qëndron në stacion" dhe se "Ke bërë sakrificë, do ngelesh pa punë" duke përmendur faktin që isha dorëhequr nga detyra e Zv/Kryetarit të KQZ disa muaj më parë dhe kisha mbi 6 muaj pa punë. Si rrjedhim pranova, ndonëse nuk më pëlqente si punë. Pasi folëm edhe për pak, u ndamë duke u përqaftuar dhe me të fala për familjarët tanë. Z.Bianku në asnjë rrethanë nuk më la të kuptoja, e aq më pak e shprehu hapur, se biseda jonë nuk i kishte pëlqyer në ndonjë aspekt. Në vijim kam takuar z.Peleshi dhe i kam bërë me dije se, sipas z.Bianku, ne vështirë se mund të merrnim një shtyrje tjetër. Sikundër edhe ndodhi realisht. Në të vërtetë kjo shtyrje u sigurua dy vjet më pas, në vitin 2016, kur Minsistrat Arben Ahmetaj dhe Ylli Manjani shkuan sërish në Strasburg dhe takuan Kryetarin e Gjykatës, por edhe z.Bianku.....Nëse do të disponohej audio regjistrimi origjinal, nga aparati origjinal që e ka bërë këtë regjistrim, do të kuptohej qartë se në bisedën tonë, nga ana ime nuk ka pasur asnjë ndikim të paligjshëm, se për shantazh as që mund të imagjinohet. "Premtimet" e shpikura sikur unë po i ofroja ndonjë vend pune z.Bianku janë**

*qesharake, sikur vetëm për faktin e thjeshtë që ai dhe familja e tij nuk do të kthehen më në Shqipëri, dhe këtë ai mua ma kishte thënë mëse njëherë. Sidoqoftë unë nuk mund t'ia lejoja kurrë vetës t'i imponohesha mikut tim, qoftë kjo edhe për dicka absolutisht të ligjshme e të moralshme sic ishte shtyrja me disa muaj të tjerë të një procedure që ishte shtyrë edhe herë tjetër, e askujt nuk i ishte dukur "e papërshtatshme" si qasje. Vlerësoj se e gjitha kjo, ishte një flluskë dhe fiasko e madhe e një pjese të politikës shqiptare, e përdorur për konjuktura banale të brendshme.*". Megjithatë edhe nëse do të kishim një kundërdeklarim në rastin konkret nga z.Ledi Bianku në kushtet e mungesës së një regjistrimi të fshehtë të bisedës të përdorshëm, përsëri, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *"1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. **Cdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.**"*. Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: *"Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është **in dubio pro reo, pra cdo dyshim shkon në favor të të pandehurit** dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës.."*<sup>41</sup> Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit ("akuzës", "veprës penale" për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt,) <sup>42</sup> ky duhet bërë në favor të të pandehurit. Sikurse u theksua më lart, bindja e brendshme e gjykatës formohet nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre. Kjo kërkesë e ligjit ka për qëllim që të detyrojë Gjykatën që para se ajo të arrijë në përfundimin e saj, lidhur me vlerësimin e provave, të marrë në shqyrtim jo vetëm njëherë anë të provës që bën fjalë për vërtetësinë e saj, por dhe anën e kundërt që e ve në dyshim ose e mohon këtë vërtetësi, **që gjykata të mbështetet jo vetëm te një provë, por në disa të tilla**, që duke i vlerësuar në tërësinë e tyre të lejojnë jo nxjerrjen e një përfundimi hipotetik, por një të vetëm dhe të pakundërshtueshëm. Pra, në rastin konkret, në çdo rast fakti do të çmohej në favor të shtetasit Denar Biba, si person i dyshuar.

26.6. Sikurse u theksuar më lartë që të kemi konfigurimin e veprës penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, nga ana objektive kërkohet që subjekti aktiv të kryejë veprën penale nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme: 1) nga ana aktive, duke premtuar për t'i ofruar, ose propozuar ose dhënë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, **çfarëdo përfitimi të parregullt** personit, i cili premtun ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike. Ndërsa nga ana pasive: 2) kërkohet që subjekti aktiv të kryejë veprën penale nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme, duke kërkuar, marrë ose pranuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë nga personi që ka kërkuar këtë veprim. Mbështetur në deklaratimet e mësipërme, Gjykata çmon se nuk provohet që shtetasi Denar Biba ta ketë konsumuar nga ana objektive këtë veprë penale, pasi nuk jemi përpara ushtrimit të ndikimit të paligjshëm, në format që parashikon neni 245/1 i Kodit Penal.

26.7. Gjithashtu, Gjykata çmon se figura e veprës penale *"Ushtrimi i ndikimit të*

<sup>41</sup> I njëjti qëndrim është mbajtur me vendimin Nr. 47, datë 07.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>42</sup> Shiko Vendimet Nr. 8, datë 08.05.2005 dhe Nr. 10, datë 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, përbën krim dhe hynë në kategorinë e veprave penale që ndiqen kryesisht. Ndodhur në këto kushte, në respektim të nenit 281 të K.Pr.Penale nën titullin “**Kallëzimi nga nëpunësit publikë**”, ku parashikohet shprehimisht se: “1. Nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale. 2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore. 3. Kur, gjatë një procedimi civil ose administrativ, zbulohet një fakt që përbën vepër penale që ndiqet kryesisht, organi përkatës bën kallëzim te prokurori. 4. Kallëzimi përmban elementet thelbësore të faktit, burimet e provës, gjeneralitetet, banimin dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e personit të cilit i atribuohet fakti, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të sqarojnë rrethanat e faktit.”, si dhe në nenin 283 të këtij Kodi nën titullin “**Kallëzimi nga ana e shtetasve**” ku parashikohet shprehimisht se: “1. Çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm. 2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit. 3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 195.”, kallëzimi është i detyruar me ligj për shtetasit kur ata marrin dijeni për kryerjen e një krimi që është kryer ose që është duke u kryer dhe jo në rastet kur kjo nuk ka ndodhur. Në rast se nuk bëhet kallëzim atëherë çdo person mban përgjegjësi penale për figurën e veprës penale të “Moskallëzim krimi” parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal. Bazuar në këto dispozita si dhe duke pasur parasysh personalitetin e z.Ledi Bianku me detyrë gjyqtar në GJEDNJ në kohën kur është bërë regjistrimi i fshehtë, Gjykata krijon bindjen se nëse nga ana e tij do të ishte konstatuar se do ishte ushtruar ndikim i paligjshëm që përmbushë elementët e figurës së veprës penale të “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, ai do të kishte bërë kallëzim penal në prokurori apo përpara oficerit të policisë gjyqësore. Fakti që një veprim i tillë nuk është bërë, i krijon bindjen gjykatë se deklaratimet e dhëna nga shtetasi Denar Biba janë të besueshme për gjykatën se një fakt penal nuk ka ndodhur.

26.8. Megjithatë, Gjykata çmon të theksoj faktin se me ndryshimet që janë bërë me ligjin Nr. 35/2017 në K.Pr.Penale, në nenin 329/c të K.Pr.Penale, nën titullin “**Revokimi i vendimit të pushimit**” parashikohet shprehimisht se: “1. Kur pas vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar, ai mund të revokohet nga gjyqtari i seancës paraprake me kërkesë të prokurorit, të viktimës ose trashëgimtarëve të saj. Kërkesa, së bashku me aktet dhe provat e reja, depozitohet në sekretarinë e gjykatës. 2. Kërkesa shoqërohet me provat e reja me pasojë mospranimi. 3. Kërkesa shqyrtohet në dhomë këshillimi. Kur vendos pranimin e kërkesës, gjykata revokon vendimin e pushimit dhe i kthen aktet prokurorit, i cili rifillon hetimet. 4. Në përfundim të hetimeve, kur nuk procedon sipas neneve 328, 329/a, 406/a ose 406/dh, të këtij Kodi, prokurori paraqet në gjykatë kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.”, vendimi i pushimit të akuzës ose të çështjes nuk merrë formë të prerë në kuptimin substancial por vetëm në kuptimin formal. Prandaj, është në çdo kohë i revokueshëm nëse dalin fakte të reja.

27. **Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale.** Në nenin 14 të Kodit Penal thuhet se: *“Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quket me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.”*. Këto forma të zbatimit të parimit të fajësisë në të drejtën penale përbëjnë edhe qëndrimin psikologjik apo subjektiv që shfaq autori ndaj veprës penale dhe nuk mund të atribuohet veprimi kriminal në mënyrë objektive apo absolute pa pasur një lidhje psikologjike me anën objektive të veprës penale. Gjykata vlerëson se shoqëria dhe e drejta penale nuk kanë asnjë interes në ndëshkimin e atyre fakteve të pamenduara, që nuk mund të dihen a të njiheshin apo të reflekseve mekanike, apo pasojave të pa përfytyruara nga ana e subjektit aktiv të veprës penale. Ligji penal parashikon vetëm ndëshkimin e atyre veprimeve a mosveprimeve që kryen me faj (në formën e dashjes apo pakujdesisë) të individit. Parimi i fajësisë në të drejtën penale mund të kuptohet në dy mënyra: i) si ndalim i atribuimit të përgjegjësisë penale për faktin e kryer nga të tjerë; si edhe ii) në kuptimin e pranisë së detyrueshme të formës së dashjes apo pakujdesisë, në elementet e veprës penale, pra të ndalimit të atribuimit të përgjegjësisë penale në mungesë të elementit subjektiv (për përmendjen e të dy mënyrave shih Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 3/2015, datë 02.11.2015, § 66, 71). Kështu subjekti aktiv i veprës penale duhet të jetë i vetëdijshëm; pra, të ketë dijeni se sjellja e tij ka përbërë një rrezik për shoqërinë dhe ai, të paktën me pakujdesi, apo me dashje nuk ka respektuar parashikimin ligjor që ndalon kryerjen e veprës penale, edhe pse ishte në gjendje, duke mos respektuar detyrimin për t’iu shmangur kryerjes së veprës penale. Detyrimi për të mos kryer veprën penale i është ngarkuar subjektit si anëtar i shoqërisë, me qëllim që të nxitet kontributi personal dhe i përgjegjshëm i tij për bashkekzistencën paqësore në shoqëri të tij. Në disa rrethana të caktuara subjekti aktiv, mund të mos jetë në dijeni të cenueshmërisë apo rrezikut të qenësishëm, që sjellja e tij mund të përbëjë për shoqërinë dhe rendin e saj juridik, për shkaqe të moshës së tij, zhvillimit mendor, dhe arsyeve të tjera objektive të pashmangshme. Parimi i fajësisë në të drejtën penale parashikon një sërë kushtesh që lejojnë atribuimin e fajit për kryerjen e një vepre penale ndaj një subjekti të caktuar që duhet të jetë në gjendje dhe i aftë për të kuptuar. Pra, parimi i fajësisë është i lidhur, jo vetëm me parimin e ligjshmërisë dhe cenueshmërisë, por sidomos me parimin e parandalimit dhe të riedukimit të autorit të veprës penale, si dhe me parimin e përpjesëtueshmërisë. Pasi që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, ai duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën.

27.1. Gjykata vlerëson se parimi i fajësisë ka të bëjë me gjendjen e brendshme psikike të subjektit aktiv të veprës penale, dhe pasqyron qëndrimin dhe pozicionin e tij ndaj kryerjes së veprës penale në botën e jashtme. Elementi subjektiv i veprës penale përbëhet nga dy aspekte, në atë se çfarë duhet të jetë në mendjen e subjektiv aktiv të veprës penale, kur plotësohet ana objektive e veprës penale (aspekti pozitiv) dhe në aspektin negativ, që konsiston në atë se çfarë nuk duhet të jetë në mendjen e subjektiv aktiv të veprës penale. I tillë mund të jetë për shembull: prania e një lajthimi në fakt, i cili e shpie subjektin aktiv të veprës penale në gabim dhe në një përfytyrim të shtrembëruar të realitetit dhe si rezultat, atij nuk mund t’i atribuohet qortim penal edhe pse është plotësuar ana objektive e veprës penale. Rast tjetër mund të përbëjë për shembull edhe lajthimi i pashmangshëm i ligjit

penal, kur mosnjohja është objektivist e paevitueshme sipas nenit 5 të Kodit Penal. Aspekti pozitiv i anës subjektive të veprës penale përbëhet nga dy elementë: vetëdija dhe dashja, pra elementi i dijenisë (intelektual) dhe elementi volitiv. Vetëdija është ndërgjegjësimi i brendshëm që individi krijon mbi faktet, domethënë mbi realitetin faktik, duke analizuar të dhënat e realitetit nga e shkuara, apo nga e tashmja dhe parashikuar të ardhmen. Të ardhmen ai nuk mund ta dijë apo ta njohë më siguri absolute. Ndërsa elementi volitiv ka të bëjë me përcaktimin e vullnetit të subjektit dhe nuk është i lidhur me realitetin faktik, në kuptimin që subjekti mund të dojë si gjëra të shkuara, të tashme, por edhe të ardhme. Elementi volitiv është i përbërë nga shkallë të ndryshme dhe të ndërmjetme, midis të cilave ndahet dashja (*dolus*) dhe pakujdesia (*culpa*). Shkalla më e lartë e elementit volitiv është dashja e drejtëpërdrejtë, në të cilin subjekti ka vetëdije të plotë të realitetit faktik, domethënë të anës objektive të veprës penale, duke e reflektuar dhe e vënë atë në qendër të analizës psikologjike të subjektit. Shkalla më e ulët e elementit volitiv është pakujdesia, në të cilën subjekti, ndonëse nuk ka vetëdije të plotë të elementit faktik, për rrethanat e faktit dhe cilësitë e tjera të tij, ai duhet dhe mund të kishte qenë i ndërgjegjshëm, domethënë në gjendje për të parashikuar realitetin faktik dhe pasojat e sjelljes së tij. Në lidhje me sjellje kriminale që nuk mund të dihen, sa i takon parimit të fajësisë në të drejtën penale, edhe pse ky parim nuk është parashikuar shprehimisht nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ky fakt nuk e ka ndaluar Gjykatën Evropiane të shprehet në lidhje me këtë parim të rëndësishëm e themelor të së drejtës penale. Kështu, në rastin *Salabiaku k. Francës*<sup>43</sup>, në vendimin e datës 7 tetor 1988, Gjykata Evropiane në një rast lidhur me mbajtjen e sendeve të paligjshme nga një individ që pretendonte mosdijeninë e tij rreth përmbajtjes së sendit (valixhe) nuk vërejti shkelje të nenit 6/2 të Konventës Evropiane. (***Shiko Vendimin Nr. 125, datë 25.10.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë***).

27.2. Gjykata vlerëson se, vepra penale e “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, kërkon si formë faji dashjen e drejtëpërdrejtë, dhe e rëndësishme është që autori i saj të veprojë me vullnet dhe ndërgjegje të plotë për të ndikuar në veprimtarinë e një subjekti funksionar publike me qëllim përfitime të parregullta për vete ose për persona të tjerë, veprime të cilat çenojnë të autoritetin e shtetit dhe veprimtarinë e rregullt të organeve të tij (*dashja direkte*). Gjithashtu, gjykata vlerëson se, ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet dhe qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarin kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi gjykata çmon se gjatë gjykimit nuk provohet që shtetasi Denar Biba të ketë kryer faktin për të cilin është regjistruar procedim penal. **Në këto kushte, përderisa nuk provohet se shtetasi Denar Biba ka kryer ndonjë veprim të paligjshëm në kuptimin penal, atëherë nuk provohet as faji, pasi nuk provohet si elementi intelektual ashtu dhe ai volitiv, që të ekzistojë faji si element thelbësor i përgjegjësisë penale.**

27. Në lidhje me subjektin e veprës penale, në nenin 12 të Kodit Penal thuhet shprehimisht se “*Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka*

<sup>43</sup>Ankimi nr. 10519/83, *Salabiaku k. Francës*.

mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç”. Kështu, personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (*condicio sine qua non*): *i*) Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe *ii*) të jetë i përgjegjshëm. Kështu, neni 17 i Kodit Penal parashikon se: “Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qënë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale”. Ky kusht ka të bëjë me domosdoshmërinë për të proceduar penalisht vetëm personat e përgjegjshëm, që kanë të paktën një ndërgjegje minimale sa për t’i bërë ato të aftë të kuptojnë rëndësinë e veprimeve që kryejnë, në mënyrë që realisht të ekzistojë ana subjektive e autorit të veprës penale, që për organin procedues do të thotë të jetë i mundur të identifikohet forma e fajësisë. Megjithatë, që të përjashtohet nga përgjegjësia penale, për shkak të gjendjes mendore, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte. **Së pari:** personi të vuajë nga një turbullim psikik ose neuropsikik. **Së dyti:** ky turbullim të ketë prishur tërësisht ekuilibrin mendor të personit. **Së treti:** turbullimi të ketë ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës. Ky kusht buron nga rregulli se përgjegjësia penale përcaktohet në momentin e kryerjes së veprës penale.

28. Sa më sipër u arsyetua, Gjykata bazuar në nenin 329/b pika “2” të K.Pr.Penale nën titullin “**Shqyrtimi i kërkesës**”, ku parashikohet shprehimisht se: “3. Kur janë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, gjykata vendos pushimin e akuzës ose çështjes.”, si dhe në nenin 328 pika 1 gërma “b” të KPr.Penale çmon se duhet vendosur pushimi i çështjes për kryerjen e veprës penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata, bazuar në nenet 328 pika 1 gërma “b”, 329, 329/a, 329/b pika 2 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në nenin 245/1 të Kodit Penal

### **VENDOSI:**

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Pushimin e çështjes penale që i përket procedimit penal me Nr. 7581 të vitit 2018, për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

**U shpall sot në Tiranë, më datë 15.02.2019.**

**SEKRETARE  
DENADA TODA**

**GJYQ TAR  
ERJON BANI**

[shqiptarja.com]